

MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJËRAVE



STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E MJEDISIT

2013-2020

Kapitulli 1: Kushtet aktuale

Cilesia e ajrit. Cilësia e ajrit¹ në zonat kryesore urbane rezulton të ketë pësuar një përmirësim në krahasim me vitin 2007, deri në 67%². Një pjesë e treguesve që ndikojnë në cilësinë e ajrit³ rezultojnë të jenë brenda normave të lejuara kombëtare dhe të BE, ndërsa për dy treguesit PM_{2,5} dhe PM₁₀, përputhshmeria me standartet evropiane është e ulët, në vlerën 30% ndërsa treguesit e O₃, dhe benzenit tejkalojnë me 1-5% standartet e BE. Përmirësimet në cilësinë e ajrit lidhen me (1) përmirësimin e infrastruktures rrugore në zonat urbane dhe (2) mbajtjen nën kontroll të përmbajtjes së squfurit në lëndet djegëse për motorrat diesel dhe benzene.

Megjithatë përpjekjet për të përmirësuar sistemin e monitorimit të cilësisë së ajrit, akoma ky sistem nuk plotëson standartet evropiane për shkak të mungesës së investimeve për blerjen e stacioneve të monitorimit, pajisjeve dhe reagenteve, kostos për mirëmbajtjen dhe kalibrimin e tyre. Aktualisht Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve është duke u asistuar nga një projekt i financuar nga KE, CEMSA që synon konsolidimin e Sistemit Kombëtar të Monitorimit në vend dhe krijimin e Strukturs Institucionale për Sistemin e Monitorimit Mjedisor.

Me ligjin e ri për taksat kombëtare dhe vendore të ndryshuar është bërë ristrukturimi i taksimit të mjeteve të përdorura. Aplikimi i taksës së re të qarkullimit si (i) taksa fikse, për litër mbi gazoilin dhe benzinën, të importuar apo të prodhuar në vend; taksa fikse për llojin e karburantit 25 lekë për naftën dhe 20 lekë për benzinën (ii) taksa e karbonit që është aktualisht mbi benzinën dhe gazoilin në masë dhe që, do të aplikohet edhe mbi dy kategori të reja nënproduktesh naftë, mbi vajgurin dhe lëndë djegëse (solarin dhe mazutin), pritet të sjellin përmirësime në cilësinë e ajrit.

Sipas VKM Nr.147, datë 21.3.2007 "Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel" lejohet vetëm tregtimi për përdorim në automjetet rrugore dhe gjeneratorët e lëndëve djegëse diesel dhe benzinës, që plotëson kërkesat e standartit shqiptar S SH EN 590 dhe S SH EN 228. VKM e mësipërme përcakton se nëse pas datës 1 janar 2009 evidentohen subjekte, që tregtojnë lëndë djegëse, me cilësi, që nuk respekton kërkesat e këtij vendimi, lëndë djegëse sekuestrohet. Gjithashtu për të reduktuar përmbajtjen e squfurit në lëndet djegëse për përdorim industrial, është miratuar VKM "Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme të lëngshme për përdorim termik e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)".

Faktorët kryesor që ndikojnë në ndotjen e ajrit janë jehonat e transportit, i cili mbetet një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit urban. Kjo lidhet me numrin e madh të automjeteve që nuk plotësojnë standartet e shkarkimeve në ajër, cilësia e lëndës djegëse që përdorin, viti i prodhimit të tyre, si dhe përdorimi i automjeteve me motor pa konvertor katalitik duke favorizuar rritjen e përmbajtjes së pluhurit si dhe shkarkimet e gazta gjatë djegjes së karburantit. Gjithashtu mungesa e sipërfaqeve të gjelbërta dhe zbatimi pa kriter i

¹ PM_{2,5} dhe PM₁₀, SO₂, NO₂, CO, Pb, O₃, dhe benzenit

² Përqindja e rasteve të përputhjes me standartet e cilësisë së ajrit, kundrejt totalit të rasteve të monitoruara është rritur nga 37% në 2007 në 67% në 2012. Përputhshmeria në masën 67% është një mesatare e të gjithë treguesve të monitoruar dhe për të gjitha zonat e monitorimit..

³ SO₂, NO₂, CO, Pb

ndërtimeve kanë ndikimin e tyre në ndotjen e cilësisë së ajrit sidomos në shkarkimin e pluhurave.

Me rritjen e transportit automobilistik sipas tendencës së deri tanishme edhe përmbajtja e NO₂ mund të arrijë vlerën kufi të lejuar, së pari në qytetin e Tiranës Durrësit, e me radhë në qytetet e tjera brenda një harku kohor 3-5 vjet. Pa ndërprerë këtë tendencë rritëse të transportit automobilistik, një ndërhyrje efektive në planifikimin urban të qyteteve respektive, ku të merret parasysh optimizimi i trafikut, përdorimi i mjeteve alternative të transportit rrugor, kontrolli teknik i automjeteve sipas standarteve të BE si rritja e sipërfaqeve të gjelberuara do të ndikonte pozitivisht në reduktimin e ndotjes potenciale mjedisore prej gazeve e tymrave të çliruar nga automjetet.

Per te permiresuar cilesine ajrit jane ndermarre disa nisma ligjore qe lidhen me sistemin e taksave dhe cilesine e lendeve djegese.

Sfidat per te ardhmen synojne përmirësimine cilësisë së ajrit urban përmes

- (i) Adoptimit plotësisht legjislationit të BE për cilësi të ajrit urban dhe shkarkimet në ajer
- (ii) Hartimit të planit kombëtar dhe planeve lokale të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit
- (iii) Forcimit të Sistemit Kombëtar të Monitorimit të ajrit urban dhe shkarkimeve në ajer sipas standarteve europiane
- (iv) Forcimit të zbatimit të legjislationit
- (v) Bashkëpunimit me pushtetin vendor për miratimin dhe zbatimin e planeve të veprimit të cilësisë së ajrit
- (vi) Forcimit të bashkëpunimit me institucionet e linjes për integrimin e politikave të cilësisë së ajrit në strategjitë sektoriale të tyre.
- (vii) Forcimi i iniciativave mbi taksat e automjeteve për të patur një sistem automjetesh miqësorë me mjedisin.


Ndryshimet klimatike. Shqipëria është anëtarësuar në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK), në janar 1995 dhe në Protokollin e Kiotos, Janar 2005. Si vend në Aneksin jo I të KKKBNK, Shqipëria nuk ka detyrime të percaktuara për të reduktuar shkarkimet e gazeve serrë. Si detyrim ndaj KKKBNK në vitin 2009 u hartua Komunikimi i Dytë Kombëtar dhe gjatë vitit 2012 ka filluar puna për hartimin e Komunikimit të Tretë Kombëtar. Në takimet e paleve të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK) të zhvilluara në Kopenhagen COP 15, Në Kankun COP16 dhe në Durban, Afrika e Jugut COP 17, Shqipëria, si Palë në KKKBNK dhe Protokollin të saj të Kiotos ka mbështetur qëndrimin e Bashkimit Evropian dhe komunitetin ndërkombëtar për të zbutur ndryshimet klimatike.

Një objektiv specifik është hartimi i një Strategjie Kombëtare për adresimin e ndryshimeve klimatike dhe integrimin e ceshtjeve të ndryshimeve klimatike në sektore të ndryshme të ekonomisë së vendit.

Komunikimi i Dytë Kombëtar (KDK) konsideron tre gazet me efekt serrë të drejtperdrejte (CO₂, CH₄ and N₂O) dhe tre gazet me efekt serrë jo të drejtperdrejte ose indirekte (CO, NO_x, SO_x and NMVOC). Përveç këtyre janë përfshirë vlerësimet për HFCs, PFCs dhe SF₆ (keto nuk ishin përfshirë në Komunikimi i Parë Kombëtar të Shqipërisë). Në vlerësimet për Komunikimin e Dytë Kombëtar si vit baze është marrë viti 2000 dhe janë plotësuar edhe seritë kohore 1990 – 2000. Një rivlerësim është bërë gjithashtu për vitin 1994.

Totali i shkarkimeve të gazeve serre në Shqipëri për vitin 2000 është 7619.90 Gg ose rreth 2.47 ton CO₂ eqv. për frymë. Sektori kryesor emetues është Energjia (44.00%) nëpërmjet transportit, i ndjekur nga Bujqësia (27.12%) dhe Ndryshimi i Perdorimit të Tokës dhe Pyjet (21.60%). Pjesa e kësaj të fundit po ulet gjithnjë e më shumë, ndërsa roli i energjisë dhe mbetjeve po rritet. Nga nën-sektoret e energjisë, transporti është ai me rritje më të shpejtë.

Në KDK për të gjithë sektorët e analizuar janë ndërtuar dy skenare: Skenari Baze dhe ai i Reduktimit të gazeve me efekte serre. Viti baze është viti 2000 dhe kuadri kohor është deri në vitin 2025. Skenari Baze konsideron zhvillimin e sektoreve pa konsideruar efektin e ndryshimeve klimatike. Skenari i Reduktimit merr në konsideratë zbatimin e një seti masash të prioritizuara, duke patur si qëllim të arrijë një reduktim të shkarkimeve të gazeve me efektin serre deri në 48% në vitin 2025 në raport me skenarin baze.



Emetimi i gazeve serre sipas skenarit Baze dhe skenarit të Reduktimit për periudhën 2010 – 2025 (Gg CO₂ eqv.).

Në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit për heqjen nga përdorimi i substancave ozonholluese, hidroklorfluorkarboneve (HCFC), për vitin 2011 janë realizuar kuotat, duke mbajtur të pandryshuar sasinë prej 120 ton të HCFC-ve.

Sfidat për të ardhmen përfshijnë (i) përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit evropian në fushën e ndryshimeve klimatike në legjislacionin kombëtar (iii) hartimin e politikave, strategjive dhe planeve të veprimit për reduktimin e GHG dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike (iv) zbatimin e detyrimeve ndaj KKKBNK (v) Rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit, dhe zhvillimit të kapaciteteve për ndryshimet klimatike në nivel qendror dhe lokal (vi) Synohet që sasia prej 120 ton të HCFC-ve të reduktohet në 108 ton në vitin 2015 duke e zvogeluar me 10% këtë sasi që nga viti 2013. Objektivi afatgjatë është zvogelimi i HCFC-ve në 29 ton deri në vitin 2040.

Në fushën e kimikateve kuadri ligjor për kimikatet dhe substancat e rrezikshme egziston, megjithatë është pjesërisht në linjë me legjislacionin Evropian në këtë fushë.

Kontrolli i lëndëve të rrezikshme mbulohet kryesisht nëpërmjet konventave përkatëse ndërkombëtare, por transpozimi i mëtejshëm i legjislacionit evropian është i nevojshëm. Mëqenëse në legjislacionin evropian, perkatesisht direktivat 76/769/EEC dhe 67/548/EEC, të cilat janë transpozuar në legjislacionin ekzistues kombëtar, janë shfuqizuar si dhe janë identifikuar boshllëqe të tjera në legjislacionin kombëtar lidhur me kimikatet, ka dalë nevojë për hartimin e një legjislacioni të ri kombëtar në fushën e kimikateve dhe perkatesisht për transpozimin në legjislacionin kombëtar të rregullores (EC)1272/2008, “Mbi klasifikimin,

etiketimin dhe paketimin e substancave dhe perzierjeve” dhe rregullores REACH (EC) 1907/2006.

Ndërsa procedura për menaxhimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve, përfshirë bazën ligjore, regjistrimin dhe kontrollin është e kompletuar, ende mbetet punë për të bërë për plotësimin dhe zbatimin e legjislacionit për kimikate të tjerë, si kimikatet industriale, biocidet, kimikatet e konsumit.

Me propozim dhe me kontributin e projektit SAICM-QSP “ Forcimi i kapaciteteve për implementimin e SAICM në Shqipëri”, Ministria e Shëndetësisë ka përgatitur së fundmi një draft-ligj për biocidet dhe synon të përafrojë plotësisht direktivën e BE 98/8 me legjislacionin dytësor përkatës.

Adoptimi i legjislacionit European, kerkon ngritjen e rolit te strukturave shtetore, perfshirjen e organizatave joqeveritare dhe sindikatave te puntoreve qe ne fillim te ndermarrjes se iniciativave ligjore dhe ne veçanti, kur kemi te bejme me kimikate te rrezikshme. Është nevojë e domosdoshme ngritja e nje institucioni koordinues për menaxhimin e kimikateve, siç do te ishte **zyra e menaxhimit dhe regjistrimit te kimikateve** ne zbatim te detyrave të parashtruara nga ligji Nr 9108 dt 17.7.2003 “Per substancat dhe preparatet kimike”.

Ne Planin Kombetar te Zbatimit te MSA eshte parashikuar krijimi i kesaj zyre brenda vitit 2015. Kjo zyre do te sherbeje edhe si sekretariat i një (nën) komiteti ndersektorial per menaxhimin e kimikateve, i cili është gjithashtu shumë i nevojshëm.

Institucionet qendrore hasin në punën e tyre mangësi e probleme lidhur me angazhimet përkatëse mbi menaxhimin e kimikateve, si mungesa e theksuar e stafit të mjaftueshëm, buxheti i pamjaftueshëm për ndjekjen në vazhdimësi të problemeve si dhe mangësi në infrastrukturë. Mungesa e stafit përbën nje problem shume serioz, që mund të çnojë ndjeshëm aftësinë e vendit për t’iu përgjigjur kërkesave të anëtarësimit në BE. Rritja e numrit te stafit që angazhohet me menaxhimin e kimikateve është shumë kritike. Përveç një rritjeje sasiore të stafit, është po aq e rëndësishme që të rekrutohet staf cilësor, i aftë për të përballuar kërkesat e shumta të kësaj fushe që kërkon nivel shumë të lartë ekspertize.

Mungojnë kapacitetet e mjaftueshme në institucionet që duhet të mbledhin dhe shpërndajnë **informacionin**. Për të përmirësuar situatën aktuale mbi menaxhimin e informacionit, është e nevojshme rritja e buxhetit, organizimi i trainimeve dhe rritje e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për informim. Në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e SAICM në Shqipëri është krijuar faqja e internetit www.chemicals.al si mjet për shkëmbimin e informacionit lidhur me menaxhimin e kimikateve.

Në Republikën e Shqipërisë nuk ka akoma një **regjistër të kimikateve** që të plotësojë kërkesat e legjislacionit European. Nevojitet krijimi i bazave të të dhënave p.sh. për kimikatet e përdorur në industri, për kimikatet e rrezikshme, si biocidet, PMB, për planet e emergjencave, etj.;

Nuk ka asnje **qender informacioni ne vend lidhur me helmimet nga kimikatet**, dhe kapacitetet aktuale ne terma praktikë jane te kufizuara, veçanerisht per transportin e viktimave ne rastin e aksidenteve qe perfshijne kimikatet e rrezikshme.

Për disa klasa kimikatesh mungon informacioni i nevojshëm dhe udhëzuesit për masat e sigurisë dhe mbrojtjes nga këto lloj kimikatesh.

Mekanizmat ekzistues punojne te ndare sipas problematikes dhe specifikes se tyre. Ata nuk i mbulojne te gjitha aspektet e rendesishme te kimikateve, te cilat kerkojne nje kooperim dhe koordinim ndersektorial shume të mirë. Mungon gjithashtu koordinimi në nivel kombëtar i zbatimit të kërkesave të marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e kimikateve. Është domosdoshmeri krijimi i nje **komiteti nder-sektorial** per menaxhimin më të mirë të

kimikateve. Termat e referencës për funksionimin e këtij komiteti janë përgatitur në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e SAICM në Shqipëri” dhe janë të disponueshme në faqen e internetit www.chemicals.al.

Nuk ka nje dokument udhezues lidhur me **incidentet industriale nga kimikatet e rrezikshme**, menaxhimin e incidenteve, toksikologjine ne pergjithesi, metodat e dekontaminimit, perdorimit te antidoteve apo pajisjeve ndihmese gjate ndodhjes se nje emergjence kimike. Rritja e kapaciteteve ne nivel kombetar, rajonal dhe lokal i autoriteve kompetente per identifikimin dhe vleresimin e raporteve te sigurise se aktiviteteteve industriale qe perbejne risk per aksident industrial per shkak te substancave te rrezikeshme, perben nje kerkese te domosdoshme.

Qendra Kombetare e Trajnimit duhet te organizoje trajnime ne nivel lokal per **parandalimin, gadishmerine dhe pergjigjen ndaj emergjencave kimike** per autoritetet kompetente dhe operatoret industriale. Nevojitet gjithashtu rritja e ndergjegjesimit te popullsise mbi rrezikun e aksidenteteve industriale.

Ka nje nevoje urgjente per ngritjen e nje taskforce/komiteti per zbatimin e **Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetit** (2005) me perfaqesues nga te gjitha Ministrite dhe sektoret perkates ne Shqiperi e cila duhet te jete e lidhur me Piken Kombetare te Kontaktit (PKK) prane Institutit te Shendetit Publik. Ky komitet duhet te planifikoje, vereje dhe monitoroje zbatimin e RNSH (2005), përfshirë edhe problematikën përkatëse lidhur me kimikatet.

Infrastruktura laboratorike është në mjaft raste e vjetëruar dhe jo bashkëkohore. Metodologjia e përdorur jo gjithmonë bazohet në metoda standarde dhe ka mangësi të shumta, si probleme ne sigurimin e serviseve të aparaturave, në sigurimin e reagentëve e standardeve të kalibrimit, etj. Nuk është vendosur ende në të gjithë laboratorët sistem i brendshëm cilësie, dhe vetem një numër i kufizuar laboratorësh janë akredituar. Mungojnë procedurat për menaxhimin e kimikateve dhe materialeve të rrezikshëm si dhe për eliminimin e mbetjeve të tyre.

Ndërgjegjësimi për rrezikun ndaj kimikateve në të gjitha grupmoshat si dhe në të gjitha nivelet është ende i ulët. Ndërgjegjësimi si dhe trajnimi i grupeve të ndryshme të profesionistëve, si fermerëve, transportuesve, industrialistëve, stafit teknik, si edhe i konsumatorit, për sigurinë në përdorimin e kimikateve, është një hap i rëndësishëm për uljen e këtij risku.

Në kuadër të nevojës për forcimin e kapaciteteve mbi menaxhimin e kimikateve në vend nevojitet të ngrihen programe të mirëfillta **trajnimesh** për inspektorët dhe stafet profesionale, të cilat të jenë të qëndrueshëm dhe metodologjikisht të konsoliduar si në trajtën e programeve të plotë për formimin e kuadrit të ri, ashtu edhe programe të shkurtër rifreskues.

Është i nevojshëm përmirësimi i kushteve të përdorimit të kimikateve për shëndetin publik; nevojiten më shumë fonde për blerjen e lëndëve biocide, si edhe të materialeve manipuluese, veshjeve mbrojtëse të punonjësve etj. Shumë i nevojshëm është edhe trajnimi i stafeve që kryejnë trajtimet me biocide.

Nevojitet një projekt i përbashkët midis MSh, ISHP dhe Bashkive, i cili të jetë efikas për **një program të kontrollit të integruar të dëmtuesve (pesteve)** në shëndet publik. Po kështu, duhet promovuar edhe **menaxhimi i integruar i dëmtuesve të kulturave bujqësore**.

Mbetet ende problem mbledhja dhe shpërndarja e informacionit për **sasitë dhe llojet e mbetjeve industriale të reja që gjenerohen** nga aktiviteti i subjekteve industriale të licensuara pas vitit 1992.

MMPAU ka bërë një punë të mirë për identifikimin, prioritizimin dhe studimin e **vatrave të ndotura mjedisore**. Vatra mëproblematiche e Porto-Romanos dhe vatra të tjera të ndotura janë pastruar me ndihmën e UNDP dhe me kontributin e Qeverisë së Hollandës. Në vazhdim të përpjekjeve të MMPAU per identifikimin dhe pastrimin edhe të vatrave të tjera problematike, është bërë edhe një studim paraprak i 35 pikave të nxehta mjedisore në

Shqipëri dhe është përcaktuar një listë e shkurtër prej 14 vatrash ndotjeje prioritare për ndërhyrje rehabilituese.

Përgjegjësia për ndotjen është një çështje e rëndësishme në pastrimin e zonave të ndotura dhe privatizimit të tyre. Nuk ka një legjislacion specifik për përgjegjësinë për ndotjen industriale të mëparshme dhe nuk është e qartë se kush duhet të paguajë.

Nevojitet hartimi **dhe zbatimi i një plani kombëtar veprimi për menaxhimin e kimikateve**, çka do mundësojë plotësimin e mangësive të shumta të identifikuara gjatë rishikimit të Profilit Kombëtar.

Sfidat per te ardhmen perfshijne ngritjen e sistemit kombëtar të menaxhimit të kimikateve ne perputhje me rregulloret e BE, Konventen e Roterdamit, Konventen e Stokholmit, Konventen e Bazelit dhe Sistemin Global te Harmonizuar (GHS) nepermjet (i) përafrimit te legjislacionit kombetar me atë komunitar ne fushen e kimikateve dhe përmirësimit te koordinimit ndërinstytucional per zbatimin e plotë te tij (ii) *Ngritja e Zyres se Menaxhimit te Kimikateve* (iii) hartimi te planit kombetar te veprimit per menaxhimin e kimikateve duke synuar parandalimin e ndotjes se mjedisit dhe mbrojtjen e shendetit te njerezve

Mbetjet. Menaxhimi i mbetjeve ne vend është akoma ne një nivel te ulet. Me sisteme për grumbullimin e mbetjeve te ngurta janë pajisur vetëm qytetet, por jo zonat rurale. Sasia e mbetjeve qe riciklohet eshte 10%. Kryesisht mbetjet asgjësohen ne vend grumbullimet e mbetjeve. Përvec landfill-eve te Sharres dhe Bushatit dy venddepozitime te tjera te mëdha po planifikohen te bëhen brenda një afati te shkurtër (2013): një ne Korçe/ Maliq (mbështetur nga KfW) dhe një tjetër ne Sarande/Bajkaj (mbështetur nga Banka Botërore).

Nuk ka një sistem te sigurte për administrimin e mbetjeve te rrezikshme (atyre te prodhuara nga industrinë dhe ato shtëpiake). Sistemi i menaxhimit te mbetjeve te rrezikshme është shume i dobët dhe pjesa me e madhe e grumbullimit te mbetjeve kryhet nga sektori privat, gjithashtu edhe impiantet e riciklimit janë ne pronësi te sektorit privat.

Ndërgjegjesimi I publikut per menaxhimin e mbetjeve eshte ne nivele te uleta.

Politika e programit te menaxhimit te mbetjeve synon menaxhimin e qendrueshem te mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit nepermjet transpozimit dhe zbatimit te kerkesave te direktivave te BE ne fushen e menaxhimit te mbetjeve, zbatimit te Strategjise dhe Planit Kombetar te Menaxhimit te Mbetjeve si dhe hartimit dhe zbatimit te planeve te veprimit te menaxhimit te mbetjeve ne nivel rajonal dhe lokal.

Hapa ate rëndesishem jane hedhur ne fushen e përafrimit te legjislacionit te BE ne fushen e mbetjeve:

- ✓ VKM 175, date 19.01.2011 “ Per miratimin e Strategjise dhe Planit Kombetar te Menaxhimit te Mbetjeve “
- ✓ Ligji nr. 10463, date 22.9.2011 “ Per menaxhimin e integruar te mbetjeve “
- ✓ Vendim nr. 705, datë 10.10.2012 “ Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës”
- ✓ Vendim nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”
- ✓ Vendim nr. 178, datë 6.3.2012 “ Për incinerimin e mbetjeve”
- ✓ Vendim nr. 452, datë 11.7.2012 “Për landfillet e mbetjeve”
- ✓ Vendim nr. 765, datë 7.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”
- ✓ Vendim nr. 866, datë 4.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”

Sfidat në fushën e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve janë: (i) ngritja dhe funksionimi i Sistemit të Integruar të menaxhimit të mbetjeve; (ii) ndërgjegjësimi i komunitetit per trajtimin e mbetjeve; si dhe (iii) bashkërendimi administrativ ndërmjet strukturave qendrore dhe

vendore për zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe qartësimin funksional të tyre.

Në fushën e mbrojtjes së natyrës është realizuar transpozimi i Direktivave kryesore të kësaj fushe, respektivisht Direktivës së Habitaveve dhe Direktivës së Shpendëve, duke arritur në një masë transpozimi mbi 80 % për këto Direktiva.

Jane hartuar dhe miratuar prej vitit 2006 një numër ligjesh të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit që transpozojnë direktivat e sipërpervendura si: Ligji “Për mbrojtjen e faunës së eger”, Ligji “Për gjuetinë”, Amendimi i Ligjit “Për zonat e Mbrojtura”, Ligji “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të tregëtimit ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe floras së eger” si dhe një numër aktesh nenligjore në zbatim të tyre.

Ruajtja dhe rritja e larmisë biologjike është synuar përmes rritjes së sipërfaqes së zonave të mbrojtura nga 10,4 % ose 303 mijë ha të territorit të vendit në vitin 2007 në 15,8 % ose 455 mijë hektare në fund të vitit 2012(*) nëpërmjet shpalljes së Zonave të reja të Mbrojtura si dhe zgjerimit të atyre ekzistuese duke kontribuar në sigurimin e statusit të favorshëm të ruajtjes duke siguruar ruajtjen dhe mbijetesën e llojeve. Tabela e rrjetit aktual dhe harta e Zonave të Mbrojtura është dhënë në Aneksin bashkelidhur.

Është realizuar përgatitja e Planeve të Menaxhimit për 10 Zona të Mbrojtura (disa prej tyre janë në perfundim).

Është realizuar zbatimi në praktike të planeve të menaxhimit të miratuara dhe ndertimi i kapaciteteve të administratave të zonave të mbrojtura, kryesisht në ato zona të mbrojtura në të cilat zbatohen projekte të donatoreve si: Liqeni i Shkodrës, Parku Kombëtar Prespe, Parku Kombëtar Divjake-Karavasta, Parku Kombëtar Detar Sazan-Karaburun

Sfidat për të ardhmen përfshijnë përgatitjen për identifikimin dhe ngritjen e rrjetit Natura 2000 të zonave të vaçanta të ruajtjes me rëndësi për komunitetin evropian. Zbatimi i planeve të menaxhimit për ato ZM që kanë plane të miratuara. Forcimi i zbatimit të ligjit dhe ngritja e kapaciteteve administrative të stafit të administratave të zonave të mbrojtura dhe organeve të kontrollit për ruajtjen e florës dhe faunës së egër përbëjnë prioritetet.

Një nga objektivat e realizuara të **politikës në sektorin pyjor**, nëpërmjet programeve të realizuara është arritur transferimi i pyjeve dhe kullotave drejt 315 njësiteve të qeverisjes vendore për të siguruar gjithë përfshirjen duke i mbështetur ato me plane menaxhimi dhe punime pyllëzimi dhe përmirësimi në pyje. Sipërfaqja e fondit pyjor kullësor është mbuluar me plane mbarështimi deri në vitin 2012, është rritur me 48% krahasuar me vitin 2007 nga punimet pyjore të kryera në 12.000 ha pyje të degraduar, erozioni është reduktuar me rreth 200.000 ton sedimente. Për parandalimin e aktiviteteve të paligjshme nga ana e strukturave të Policisë Pyjore me masat e marra janë ulur niveli i prerjeve të paligjshme në pyje, nga 8% në vitin 2007 në 55% në vitin 2011.

Sfidat për të ardhmen. Objektivat e ardhshëm do të jenë: (i) përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit evropian në fushën e pyjeve dhe kullotave; (ii) rritja e kapaciteteve të menaxhimit të pyjeve komunale nëpërmjet granteve konkurruese dhe forcimit të kapaciteteve; (iii) përmirësimi i sistemit të informacionit dhe data bazës pyjore; (iv) forcimi i sistemit të kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit në pyje; (v) përmirësimi i marrëdhënieve rajonale, aplikime të përbashkëta në programe ndërkombëtare dhe unifikimin e teknologjive e metodologjive; (vii) aplikimi në programe kombëtare e ndërkombëtare për të siguruar një mbështetje të nevojshme për zhvillimin e pylltarisë në vend.

Në fushën e administrimit të burimeve ujore ka përfunduar ligji i ri për “Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i cili është miratuar në Parlament.....; Brena vitit 2016 është parashikuar të miratohen të gjitha aktet nenligjore në zbatim të ligjit të ri “Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”.

Ka perfunduar hartimi i Planit te menaxhimit te basenit te lumit Mat, gjithashtu eshte miratuar VKM Nr. 643, date 14.09.2011 “Per miratimin e Strategjise Kombetare Sektoriale te Sherbimeve te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve, per Ujesjelles-Kanalizimet”;Eshte firmosur nje Memorandum Mirekuptimi “Per Realizimin e masave per rregullimin e regjimit uJOR te pellgut ujembledhes te liqenit te Shkodres, lumit te Bunes dhe Drinit” si dhe eshte firmosur Memorandumi i Mirekuptimit per Drinin: “Nje vizion i perbashket strategjik”, midis Shqiperise dhe vendeve fqinje. Menaxhimi i baseneve ujembledhës ne përputhje me planet e menaxhimit te tyre ka nje rritje prej 17% , krahasuar me vitin 2007.Nga monitorimi i ujerave rezulton se perqindja e rasteve të përputhjes se treguesve te cilesise ujerave; NBO5, NH4, O2 i tretur, NO3, P-total, me standartet europiane te cilesise së ujerave, eshte rritur me 8% ne krahasim me vitin 2007.

Sfidat per te ardhmen (i) Permiresimi dhe forcimi i zbatimit te legjislacionit (ii) Forcimi i autoriteteve pergjegjese ne nivel qendror dhe lokal (iii) Hartimi i planeve te menaxhimit te te gjitha baseneve te lumenjve si dhe krijimi i kadastres uJore elektronike; (iv) Hartimi i Strategjise Kombetare te Menaxhimit te Integruar te Ujerave; (v)Nenshkrimi i marreveshjeve per menaxhimin e ujerave nderkufitare me Republikën e Kosoves dhe Maqedonine perkatesisht ne 2012 dhe 2013; Forcimi i bashkepunimit dhe koordimit midis MMPAU dhe institucioneve qe perdorin dhe monitorojne rezerva uJore, per nje perdorim sa me racional dhe efikas te tyre.

Ne fushen e peshkimit jane forcuar kapacitetet administrative si dhe eshte permiresuar sistemi i grumbullimit te te dhenave, duke permiresuar plotesimin e log-book-eve. Jane instaluar aparatet e Blu-Box-eve me qellim forcimin e vezhgimit mbi floten e peshkimit si mjeti me efikas kunder peshkimit ilegal, te parregullt dhe te paraportuar. Per ujerat e brendshme eshte zbatuar ndalimi i aktivitetit te peshkimit ne liqenet kryesore te vendit me qellim mbrojtjen e specieve autoktone ne fazen e riprodhimit si dhe eshte kryer procesi i prokurimit publike per licensimin e subjekteve. Per subjektet e akuakultures eshte kryer censusi i pergjithshem. U miratua ligji i ri per peshkimin dhe po punohet per hartimin e draftit te ligjit e ri te Akuakultures si dhe po pergatiten akte nenligjore per peshkimin.qe transpozojne gjithë direktivat e BE-se ne peshkim dhe akuakulture, te perfshira ne Politiken e Perbashket te Peshkimit.

Sektori i akuakultures reflekton nje zhvillim te qendrueshem, miqesore me mjedisin dhe ekonomikisht e forte, konkuruese ne treg nepermjet implementimit te sukseshem te skemave kualitative dhe te certifikuar, si dhe eshte ne monitorim te vazhdueshem si ne aspekte teknike ashtu dhe ekonomike.

Jane selektuar dhe legalizuar zonat e percaktuara per zhvillim te akuakultures, fillimisht ne ujerat detare dhe me pas per ujerat e brendshme, shoqeruar edhe me kapacitetet prodhuese per cdo zone.

Ne liqenet natyrore ka nje rritje te qendrueshme te resurseve peshkore ne pergjithesi dhe vecanerisht te specieve autoktone, si rezultat i garantimit te ndalimit te peshkimit ne fazen e riprodhimit te specieve autoktone.

Bashkepunimi rajonal eshte koherent dhe eshte i reflektuar ne aspekte te ndryshme bashkemenaxhimi dhe nderveprimi ne sektorin e akuakultures dhe te ujerave te brendshme.

Ne zbatim te Ligjt Nr. 64/2012, date 31.05.2012 “Per Peshkimin”, po punohet per hartimin e akteve nenligjore ne zbatim te tij si:

- a) VKM “Per percaktimin e nje regjimi kontrolli per te garantuar respektimin e rregullave te politikave menaxhuese ne peshkim”.
- b) VKM “Per masat menaxhuese per shfrytezimin e qendrueshem te burimeve peshkore ne det”.

- c) VKM “Per ngritjen e nje sistemi per parandalimin, shkurajimin dhe eleminimin e peshkimit te paligjshem, te parregulluar dhe te paraportuar (PPP) dhe krijimin e skemes se certifikimit te zenieve ne peshkim”.
- d) VKM “Per grumbullimin, menaxhimin dhe perdorimin e te dhenave ne sektorin e peshkimit dhe mbeshtetjen per keshillimin shkencor lidhur me politiken shqiptare te peshkimit”.
- e) VKM “Për krijimin e një kuadri kombëtar për grumbullimin, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor lidhur me politikën shqiptare të peshkimit”.

Ligji i ri i peshkimit dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij, parashikojne permiresime ne përputhje me kërkesat e stadi aktual, pasi ne ligjin e vjeter te peshkimit dhe ne aktet nenligjore ne zbatim te tij:

- a) mungonin fusha te rëndësishme të Politikës se Përbashkët te Peshkimit te Bashkimit Evropian, dokumenta programatik te Unionit për mbështetjen dhe zhvillimin e sektorit te peshkimit.
- b) nuk reflektonin legjislacionin me te fundit te BE ne fushën e peshkimit dhe akuakultures;
- c) nuk mundësonin nxjerrjen e akteve nenligjore (VKM) për përafrimin e legjislacionit ne rastet kur nevojitet përfshirja e disa institucioneve sidomos ne pjesën e menaxhimit te sektorit;
- d) nuk parashikonte dispozita ne lidhje me programet e monitorimit te resurseve dhe kërkimin shkencor;
- e) kishte mangësi ne lidhje me grumbullimin e te dhënave ne peshkim dhe akuakulture;
- f) mungonin dispozitat mbi mbështetjen strukturore ne te gjithë sektorët e peshkimit.
- g) nevojitej një rishpërndarje me e mire e penaliteteve si dhe
- h) zgjerimin e tyre ne përputhje me dispozitat e reja qe do te parashikonte një ligj i ri.

Nepermjet ketyre akteve kemi synuar te perafrojme direktivat e BE-se dhe te organizmave te saj si FAO, GFCM etj, per fushen e peshkimit, me qellim garantimin e nje peshkimi te pergjegjshem, te qendrueshem e ne vazhdimesi.

Sot licensat per mjetet lundruese ne det, jepen nga QKL, pas miratimit nga Komisioni i Lejeve dhe Licensave, komision qe mblidhet çdo dite te Premte.

MMPAU(Drejtoria e Peshkimit) bashkepunon me strukturat rajonale si BE, FAO, GFCM, ADRIAMED,etj kjo ne kuader te bashkepunimit rajonal te mesdheut.

Me mbeshtetjen financiare te BE, nepermjet Projektit IPA-2008, u be e mundur paisja e gjithe anijeve mbi 12 metra me sistemin Blue-Box.

Peshkimi eshte mbeshtetur edhe nepermjet zhvillimit te disa workshop-eve qe synonin permiresimin e sistemit te MCS-se nga Inspektoret e Peshkimit dhe drejtuesit e OMP-ve te Porteve te Peshkimit.

Akuakultura dhe ujerat e brendshme.

Po finalizohet ligji i ri “*Per Akuakulturen*”, i cili pervecse perafron direktivat e BE-se se fushes, ka futur konceptin dhe implementimin e Zonave te Percaktuara per Akuakulture (AZA) si dhe Akuakulturen biologjike (*te dyja jane reflektim i direktivave te BE-se dhe rekomandime te GFCM-se*), me qellim garantimin e nje akuakulture te qendrueshme, te forte ekonomikisht dhe miqesore me mjedisin.

Ky sektor ka zhvillime te rendeshme, si ne ate intensive detare ashtu dhe ne ate gjysem intensive ne ujerat e brendshme tokesore, cfare e ben imperative hartimin e akteve ligjore te vecanta nga Sektori i Peshkimit Detar. Ligji i ri **“Per Akuakulturen”** se bashku me aktet perkatese nenligjore do ti paraprijë zhvillimeve te metejshme te ketij sektori brenda nje kuadri te rregulluar.

Funksionon rregullisht procesi i prokurimit publik per kontraktimin e subjekteve ne ujera te brendshme dhe akuakulture.

Per ujerat e brendshme eshte bere ndalimi i perkohshem i aktivitetit te peshkimit ne liqenet kryesore te vendit, me Urdher Ministri, me qellim mbrojtjen e specieve autoktone ne fazen e riprodhimit te tyre.

Vendi yne bashkepunon me strukturat rajonale si FAO-GFCM dhe Projektin Adriamed i cili jep mbështetje forcimit te bashkëpunimit rajonal. Me mbështetjen e Adriamed eshte kryer nje census i aktivitetit te akuakultures dhe ujerave te brendshme te vendit (viti 2010) i cili synon ta vazhdoje kete mbeshtetje per nje riciklim te ketij studimi per vitin 2013.

FAO, nga ana e saj, nepermjet Kooperimit teknik ka mbeshtetur sektorin e Akuakultures, nepermjet te disa workshop-eve, qe synonin standartet e larta te produkteve te akuakultures permes skemave cerifikuese dhe politikave te tregut te tyre, kjo, vecanerisht per molusqet e Butrintit.

Sfidat për të ardhmen lidhen me (i) plotesimin kuadrit te ri ligjor me akte nenligjoreper forcimin e luftes kunder peshkimit ilegal, te paraportuar dhe te parregullt, ne zbatim te legjislacionit qe do te miratohet;(ii) Sigurimi i nje sistemit real sistematik dhe te permiresuar te grumbullimit te te dhenave mbi floten e peshkimit, zeniet, zbarkimet dhe gjendjen biologjike te popullatave ne ujerat shqiptare; (iii) Investime strukturore ne sektorin e peshkimit (Porti i Peshkimit ne Durres, tregjet e shitjes me shumice te peshkut)(iv) Forcimi i bashkepunimit rajonal dhe nderkombetar.

Kapitulli 2: **Vizioni Politikat dhe Qellimet e Politikave**

Vizioni

Vend me një zhvillim të qëndrueshem social dhe ekonomik, duke mbrojtur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi, nëpërmjet menaxhimit të integruar të tyre dhe duke promovuar vlerat mjedisore e duke i vendosur ato në perfitim të prosperitetit ekonomik.

Ky vizion mbështetet në parimin e zhvillimit të integruar ku mbrojtja dhe përmirësimi i gjendjes së medimeve mjedisore garanton sigurinë e rritjes ekonomike dhe mirqënien sociale.

Politikat e mbrojtjes se mjedisit

Politikat mjedisore gjatë periudhës 2013 -2020 do të fokusohen në menaxhimin qendrueshem te mjedisit nëpërmjet:

- permiresimit te cilesise dhe reduktimin e ndotjes se ajrit dhe ndotjes akustike ne zonat kryesore urbane dhe zonat turistike;
- parandalimit dhe kontrollit te integruar te ndotjes dhe rreziqeve nga aksidentet industriale duke monitoruar dhe kontrolluar zbatimin e normave dhe standarteve te shkarkimeve ne mjedis nga operatoret industriale;

- Synimet e politikave për menaxhimin e integruar të mbetjeve gjatë periudhës 2013 -2020 do të kenë në fokus përmbytjen e standardeve kombëtare dhe ndërkombetare, trajtimin e tyre brenda këtyre standardeve dhe rritjen e ndërgjegjes sociale mbi efektet e dëmshme të mbetjeve në mjedis.
- ngritja e Sistemit Kombëtar të Menaxhimit të Kimikateve;
- mbrojtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të biodiversitetit, shtimit të sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura, menaxhimin e integruar të tyre dhe ngritjen e rrjetit ekologjik "NATURA 2000";
- adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike dhe reduktimit të gazeve me efekt serre;
- administrimin e burimeve ujore nepermjet vendosjes se nje kuadri monitoimi dhe kontrolli, per te reduktuar ndotjen e ujerave nentokesore dhe siperfaqesore nga aktivitetet e veprimtarive industriale, bujqesore dhe aktiviteteteve te popullsise ne zonat rurale dhe urbane, qe shkaktojne demtim te ekosistemeve ujore, si dhe te lumenjve nga shfrytezimi pa kriter, mbrojtja e ujerave detare, menaxhimi i ujerave nderkufitare, zvogelimi i efekteve nga permytja dhe thatesira;
- menaxhimin e qendrueshem te burimeve te gjalla te ujerave detare dhe i ujerave te brendshme;
- zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve pyjore dhe kullimore që sigurojnë shtimin e sipërfaqeve pyjore rrisin prodhimtarinë dhe aftësinë ripërtëritëse të pyjeve, parandalojnë degradimin e mëtejshëm të tokës, mbrojnë biodiversitetin e sigurojnë potencial maksimal për të përmbytshur funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale në nivel lokal, kombëtar dhe global pa cenuar ekosisteme të tjera.

Qellimet e politikave

Objektivat që synohen të arrihen gjatë kësaj periudhe të mbështetura edhe në politikat ndërsektoriale të mbrojtjes së mjedisit janë:

- Arritja e transpozimit të plote (100 %) i legjislacionit evropian: në fushën e ajrit krahasuar me 21 % në vitin 2011; në fushën e zhurmave krahasuar me 60% në vitin 2012; fushën e ndotjes dhe aksidenteve industriale krahasuar me 78 % në vitin 2012; në fushën e kimikateve 100% krahasuar me nivelin prej 20% në vitin 2011.
- Rritja me 43% në vitin 2020 krahasuar me nivelin 28% të vitit 2011, i numrit të stacioneve të monitorimit të ajrit urban sipas standarteve të BE-se ndaj totalit të stacioneve të monitorimit.
- Reduktimi i niveleve kombëtare të NO_x 15%, të PM₁₀ me 25%, të PM_{2,5} me 25% dhe të ruhen nivelet e SO₂ brenda vitit 2020 krahasuar me nivelet e vitit 2011 perkatesisht: per NO_x - 40 µ/ m³, per PM₁₀ - 83 µ/ m³, te PM_{2,5}-33 µ/ m³ dhe SO₂-8 µ/ m³.
- Reduktimi i ndotjes akustike me 20% në zonat kryesore urbane, krahasuar me vitin 2012 (vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së ditës të reduktohen nga 70 dB (A) në 56 dB (A) dhe vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së natës të reduktohen nga 55 dB (A) në 45 dB(A).
- Garantimi i përputhshmërisë së plote të operatoreve të medhenj industrial, me normat e shkarkimeve në ajër (PM₁₀, SO₂, NO_x) dhe uje sipas kerkesave te ligjit "Per lejet mjedisore" dhe standarteve të percaktuara në direktivave IPPC dhe LCP, krahasuar me vitin 2013.

- Objektivi i agreguar që synohen të arrihet për menaxhimin e integruar të mbetjeve është:
 - Asgjësimi i mbetjeve që shkojnë në landfill në masën 45%
 - Riciklimi i mbetjeve urbane në masën 55%,
 - Hartimi i planeve rajonale të menaxhimit të mbetjeve dhe zhvillimi i landfillleve rajonale
- Në fushën e Ndryshimeve Klimatike, ulja me 16% të emetimit të gazrave serë deri në vitin 2020, krahasuar me skenarin bazë (1990) ku sasia e GHG të emetuar është 18000Gg CO₂ eqv. Të reduktohet konsumi i hidroklorflorkarboneve (HCFC) me 35% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2011 ose deri në 78 ton në vitin 2020 krahasuar me 120 ton në vitin 2010;
- Në fushën e mbrojtjes së natyrës deri në vitin 2020 synohet rritja e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura në 17 % të territorit tokësor të vendit dhe shpallja e ZM-ve të reja detare dhe bregdetare dhe ruajtja e peizazhit, përmirësimi i statusit të ruajtjes për 5 % të llojeve dhe habitateve të kërcënuara të mbrojtura deri në fund të kësaj dekade si dekada e Kombeve të Bashkuara për biodiversitetin 2011-2020.
- Në fushën e pyjeve dhe kullotave, synohet menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve pyjore dhe kullimore, gjithpërfshirja e aktorve lokalë në menaxhimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori, vendosja e skemave për pagesa në ekosisteme, forcimi institucional dhe ligjor
- Përmirësimi i organizimit dhe procesit të prodhimit pyjor për pyjet e lartë, me objektivi *Formimin e njësisë të reja territoriale të prodhimit pyjor për pyjet e lartë prodhues.*
 - Realizimi i planeve të mbarështimit për 10 njësi të tilla prodhuese dhe të gjithë sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullimor prej 1 700 000 ha, azhurnimi i Kadastrës Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave,
 - Rehabilitimi nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit të sipërfaqeve të djegura si dhe rehabilitimin e kullotave me mbjellje foragjere e drusore në masën deri 15 % të sipërfaqes pyjore dhe kullimore deri në vitin 2020.
 - Parandalimi të gërryerjes së mëtejshme të tokës pyjore dhe kullimore në 25 % të sipërfaqes, deri në 2020.
 - Brenda vitit 2020 në legjislacionin kombëtar të arrihet transpozimi i plotë i plotë (100 %) i legjislacionit evropian, në fushën e pyjeve krahasuar me 50 % në vitin 2011; Sigurimi i kuadrit rregullator, institucional dhe ekonomik për zbatimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve.
 - Sigurimi i të drejtave tradicionale të përdorimit/pronësisë mbi pyjet, duke vendosur mekanizma për reduktimin e prerjeve ilegale dhe tregtimit të lëndës drusore, në masën 100 % si dhe parandalimi i zjarreve në masën 80 % të sipërfaqes së rrezikuar, krahasuar me 50 % si dhe parandalimi i zjarreve në masën 37 % të sipërfaqes së rrezikuar në vitin 2011.
 - Rritja e efektivitetit ekonomik dhe e eficiencës energjetike nga përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve shtetërore, rritjen e sipërfaqes pyjore nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit me arrime të pyjeve në masën 15% të sipërfaqes me bimësi pyjore dhe djerr, ngritja e një fidanishte pyjore për sigurimin e 4000000 fidanëve arrime të pyjeve për mbjellje. Kryerja e punimeve silvikulturore për përmirësimin e grumbujve pyjor me ndërhyrje ripërtëritëse për 30000 ha pyje.
 - Përmirësim kullotash duke realizuar deri 80% të sipërfaqes së planifikuar. Forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të fondit pyjor dhe kullimor në masën 100%.

- Vendosija deri ne vitin 2020 te sistemit te shërbimeve ne ekosistem dhe adaptimi kundrejt ndryshimeve klimatike ne masën 100%.
- Realizimi i data bazën pyjore (GIS), hartimi dhe miratimi i planeve mbarështimit për 100% të fondit pyjor dhe kullësor krahasuar me vitin 2011 që është 50% , azhurnimi i të dhënave të tyre duke realizuar 100% të objektivit si dhe krijimi i njësive territoriale me funksion prodhues dhe menaxhimi i integruar i tyre nëpërmjet teknikave te avancuara. Forcimi i sistemit të kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit në pyje.
- Vendosija e marrëdhënieve rajonale e me gjere, për shkëmbimin eksperiencave, aplikime te përbashkëta ne programe ndërkombëtare dhe unifikimin e teknologjive e metodologjive ne masën 80%. Sigurimi i mekanizmave financiare për të përmirësuar statusin e pyjeve dhe zhvillimin e sektorit te pyjeve.
- Vazhdimin e procesit permylles te transferimit te pyjeve dhe kullotave tek organet e qeverisjes vendore drejt kalimit tek komunitetet te drejtave te plota mbi përdorimin (uzufrukt), proces i cili rrit rolin e pushtetit vendor ne planifikimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore pyjore e kullësore”. Dhenia e asistences teknike dhe ligjore nepermjet shërbimit keshillimor per ngritjen e strukturave menaxhuse te pyjeve dhe kullotave ne komune (250 komuna). Perfundimi I procesit te regjistrimit te pyjeve komunale ne AKKP.
- Arritjen e nje ekuilibri te qendrueshme midis resurseve ujore te gjalla dhe shfrytezimit te tyre nga subjektet e peshkimit me qellim qe gjendja e resurseve te mbetet e qendrueshme dhe ne raport te drejte me numrin e anijeve dhe subjekteve te peshkimit. permiresimit te infrastruktures mbeshtetese ne peshkim dhe menaxhimin e saj; forcimit te konkureses dhe luftes ndaj informalitetit dhe zhvillimit ekonomikisht te qendrueshem te subjekteve ne kete sektor; permiresimit te furnizimit te tregut dhe rritjes se vleres se prodhimeve te peshkimit dhe akuakultures; ne rigjallerimin e zonave qe varen nga peshkimi dhe akuakultura; sektori i peshkimit shqiptar te arrije nivelet e zhvillimit te vendeve te BE.
 - a) Hartimi i akteve te tjera ligjore e nenligjore, per plotesimin i kuadrit te nevojshem ligjor ne pergjigje te situatave dhe problematikave qe dalin.
 - b) Forcimi i bashkepunimit me shtetet nderkufitare, qe kane si ekosistem te perbashket detar detet Adriatik e Jon (*Pellgu i Mesdheut*).
 - c) Ndertimi i 4 merkatove me shumice ne portet e peshkimit, me qellim rritjen e cilesise se prodhimit, vleres se prodhimit dhe luftes ndaj tregut informal, per rritjen e shkalles se konkureses.
 - d) Zgjerimi i porteve egzistues, ndertimi i bankinave te ankorimit te anijeve te peshkimit ne Vlore, Sarande dhe Shengjin si dhe perfundimi i ndertimit te Portit te Ri te Peshkimit ne Durres
 - e) Ngritja e infrastrukturave (*shkalleve*) te riparimit, mirembajtjes te anijeve te peshkimit ne te kater portet e vendit, me qellim rritjen e treguesve te gadishmerise teknike dhe te shfrytezimit ne peshkim te flotes. Permiresimi i ketyre treguesve te rendesishem ekonomiko-financiare do te coje ne rritjen e ndjeshme te zenies se peshkut dhe uljen e kostove te prodhimit
 - f) te cilat do ta bejne ate konkurues ne tregun e brendeshem dhe ate rajonal.
 - g) Rritja e shkalles se kualifikimit te peshkatareve, specialisteve, kapiteneve te anijeve, brigadiereve, motoristeve, rrjetapunues etj. Kjo do te realizohet mbi bazen e nje programi te caktuar prane Shkolles se Mesme ne Durres te rikonstruktuar rishtas, si dhe ne kursin me cikël 9 mujor i atashuar prane kesaj shkolle. Specialistet e larte navigator do te vazhdojne te pergaten ne Universitetin e Vlores. Per specialitete te vecanta si ihtiolog, akuakultor, mikrobiolog, armatore anijesh etj. do te synohet pergatitja e tyre ne Universitetet vendase dhe te huaja.
 - h) Perfundimi i ndertimit te Portit te Ri te Peshkimit ne Durres si dhe ndertimi i nje shkalle per riparimin e anijeve te peshkimit.

- i) Mundësia e financimit për kompensimin e TVSH së çmimit të naftës për anijet e peshkimit.
 - j) Plotesimi i kuadrit të ri ligjor për akuakulturën së bashku me aktet nënligjore
 - k) Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar
 - l) Forcimi i konkurrencës dhe luftës ndaj informalitetit dhe zhvillimit ekonomikisht të qëndrueshëm të subjekteve të sektorit të akuakulturës dhe ujërave të brendshme;
 - m) Përmirësimi i aspekteve të tregëtimit, certifikimit dhe rritjes së vlerës së prodhimeve të akuakulturës;
 - n) Në rigjallërimin e zonave që varen nga akuakultura në sektorin e akuakulturës shqiptare të arrijë nivelet e zhvillimit të vendeve të përpunuara të BE në këtë fushë.
- Në fushën e ujërave synohet që brenda vitit 2020 të arrihet transpozimi i plote 100% i legjislacionit evropian në legjislacionin kombëtar në fushën e ujërave; Miratimi i marrëveshjeve të përbashkëta me të gjithë vendet kufitare për përmirësimin e menaxhimit të rezervave ujore të përbashkëta deri në vitin 2013; Reduktimi i lejeve të shfrytëzimit të inerteve lumore deri në vitin 2014 me 100% duke lënë vetëm ato për nevojat e ndërtimit të rrugëve kombëtare deri në vitin 2020; Rehabilitimi i shtretërve të demtuar të lumenjeve me 25% deri në vitin 2020 krahasuar me vitin 2011; Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ujërave sipas legjislacionit të transpozuar në fuqi; forcimi i menaxhimit të basenve lumore nëpërmjet zbatimit të planeve të menaxhimit 100% deri në vitin 2020)

Kapitulli 3: **Objektivat e politikës dhe produktet mëdha**

Objektivat afatmesme (2013-2015)

Mbrojtja e mjedisit:

- 1). Arritja në 80% e përputhshmërisë së kuadrit normativ me rregulloret e BE në fushën e Ajrit në vitin 2015.
 - a) Hartimi i akteve ligjore dhe nënligjore për cilësinë e ajrit dhe shkarkimet në ajër
 - b) Përgatitja e planeve specifike të zbatimit të direktivave specifike të ajrit
 - c) Hartimi i planit Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së ajrit

- 2). Të reduktohen nivelet kombëtare të NO_x 8%, të PM₁₀ me 12%, të PM_{2,5} me 12% krahasuar me nivelet e vitit 2011 përkatësisht: për NO_x - 40 µ/ m³, për PM₁₀ - 83 µ/ m³, të PM_{2,5}-33 µ/ m³ dhe të ruhen nivelet e vitit 2011 për SO₂ me 8 µ/ m³.
 - d) Inspektime kontrolli në aktivitetet industriale që shkaktojnë shkarkime në ajër
 - e) Zbatimi i legjislacionit për kontrollin teknik të automjeteve
 - f) Hartimi i Programit kombëtar të monitorimit për cilësinë e ajrit
 - g) Zbatimi i legjislacionit për cilësinë e lëndës djegëse dhe krijimi të bazës së të dhënave nga AMP për cilësinë e lëndës djegëse
 - h) Inventari i shkarkimeve të ndotesve në ajër dhe planifikimi i cilësisë së ajrit i hartuar
 - i) Hartimi i Procedurave Standarte të Operimit për monitorimin e ajrit

- 3). Të reduktohet ndotja akustike me 7.5% në zonat kryesore urbane, krahasuar me vitin 2012 (vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së ditës të reduktohen nga 70 dB (A) në 65 dB dhe vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së natës të reduktohen nga 55 dB (A) në 52 dB(A).

4). Arritja ne 80% e perputhshmerise se kuadrit normativ me rregulloret e BE ne fushen e zhurmave ne vitin 2015.

- a) Perafrimi i kuadrit ligjor dhe nenligjor me kerkesat e direktives europiane per zhurmat
- b) Hartimi i planeve lokale te zhurmave ne mjedis
- c) Pergatitja e hartes kombetare te zhurmave
- d) Vleresimi i zonave me kerkesa strikte ndaj zhurmave (Spitale, Shkolla, Azile, Kopshte, Çerdhe etj), dhe propozimi i masave perkatese per minimizimin e zhurmave
- e) Pajisja me leje mjedisi e aktiviteteve te sherbimit social dhe monitorimi izbatimit te kushteve te lejes nga IM.
- f) Forcimi i zbatimit te legjislacionit per zhurmat

5). Brenda viti 2015 te filloje procesi i rishqyrtimit te lejeve mjedisore te integruara te tipit A dhe miratimi i planeve te perputhshmerise per 100% te operatoreve industriale, krahasuar me vitin 2012.

6). Arritja ne 80% e perputhshmerise se kuadrit normativ me Rregulloren REACH dhe CLP te BE ne fushen e kimikateve ne vitin 2015.

6.1 Hartimi i legjislacionit te ri kombëtar ne fushen e kimikateve dhe perkatesisht per transpozimin ne legjislacionin kombetar të rregullores (EC)1272/2008, “Mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe perzierjeve” dhe rregullores REACH (EC) 1907/2006.

6.2 Hartimi dhe zbatimi i planit kombëtar për menaxhimin e kimikateve

6.3 Ngritja e zyres se menaxhimit te kimikateve

6.4 Krijimi i nje komiteti nder-sektorial per menaxhimin më të mirë të kimikateve.

6.5 Ngritja e nje taskforce/komiteti për zbatimin e Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetit.

7). Ulja e nivelit te clirimit te gazeve me efekt serre me 8% ne vitin 2015, krahasuar me skenarin baze (18000Gg CO2 eqv)

7.1 Ulja e nivelit te substancave ozonholluese Hidroklorflorkarbon (HCFC) ne vitin 2015 me 10% krahasuar me vitin 2011 ose nga 120 ton/vit ne 2010 ne 108t/vit ne 2015, me qellim qe te kontribuohet per parandalimin e ndryshimeve te klimes.

7.2 Brenda vitit 2015 hartimi i Strategjise Kombetare per Ndryshimet Klimatike

7.3 Zbatim i kerkesave te Traktatit te Komunitetit te Energjise te ratifikuar nga Parlamenti.

7.4 Zbatimi i kerkesave te legjislacionit per energjite e rinovueshme dhe eficinces se energjise

7.5 Adoptimi i lehtësirave fiskale për investime në përdorimin me efience te burimeve natyrore.

8). Arritja ne 55 % e perputhshmerise se kuadrit normativ me direktivat te BE ne fushen e Ndryshimeve Klimatike ne vitin 2015.

9) Ne fushen e mbrojtjes se natyres dhe biodiversitetit nen-objektivat sektoriale jane:

- ✓ Adresimi i shkaqeve te humbjes se biodiversitetit duke nderthurur (mainstreaming) biodiversitetin ne nivel qeveritar dhe ne shoqeri;
- ✓ Reduktimi i presionit direkt mbi biodiversitetin dhe promovimi i perdorimit te qendrueshem te tij.
- ✓ Permiresimi i statusit te biodiversitetit permes ruajtjes se ekosistemeve, llojeve dhe biodiversitetit gjenetik;
- ✓ Zgjerimi i perfitimeve per te gjitha nga sherbimet e biodiversitetit dhe te ekosistemeve.
- ✓ Zgjerimi i zbatimit nepermjet planifikimit pjesemarres (gjitheperfshires), menaxhimit te njohurive dhe ndertimit te kapaciteteve.

Keto objektiva specifike do te arrihen nepermjet masave te meposhtme:

10) Arritja e perafrimit te plote te direktivave te fushes se mbrojtjes se natyres, biodiversitetit dhe peizazhit.

10.1 Perafrimi i plote i Direktives se Habitaveve 92/43/EEC, nepermjet hartimit te akteve nenligjore – Vendimit te Keshillit te Ministrave;

10.2 Perafrimi i plote i Direktives se Shpendeve (2009/147/EC) nepermjet hartimit dhe miratimit te akteve nenligjore te planifikuara ne PKZMSA si akte nenligjore te Ligjit “Per mbrojtjen e faunes se eger” dhe te Ligjit “Per gjuetine”: Vendime te Keshillit te Ministrave dhe Rregullore;

10.3 Transpozimi i Direktives “Per mbajtjen e kafsheve ne Kopshtet Zoologjike”;

10.4 Zbatimi ne praktike i Rregullores 338/97 te BE-se per tregetine nderkombetare te llojeve te rrezikuara te flores dhe faunes se eger;

10.5 Aderimi i Shqiperise ne Konventen Evropiane te Peizazhit;

11) Rritja e siperfaqes se Zonave te Mbrojtura ne 17 % te siperfaqes tokesore te vendit dhe shtimi i siperfaqes se Zonave te Mbrojtura detare dhe bregdetare ne nivele te njejta me mesataren e vendeve te BE-se dhe Aichi targets te Konventes se biodiversitetit;

11.1 Shtimi i siperfaqes se Zonave te Mbrojtura nepermjet shpalljes se nje zone te mbrojtur ose zgjerimit te nje zone te mbrojtur ekzistuese çdo vit per shtimin e siperfaqes se Zonave te Mbrojtura;

11.2 Pergatitja e dokumentit strategjik per zonat e mbrojtura detare dhe bregdetare ne Shqiperi;

11.3 Pergatitja e studimeve dhe hartes GIS per zona te veçanta te identifikuar per t’u shpallur Zona te Mbrojtura detare dhe bregdetare.

11.4 Zgjerimi i rrjetit ekzistues te monitorimit te biodiversitetit sipas indikatoreve te rekomanduara nga Agjencia Evropiane e Mjedisit per fushen e natyres.

12) Hartimi dhe zbatimi i planeve te menaxhimit te zonave te mbrojtura dhe planeve te veprimit te llojeve dhe habitaveve, per gatitjet per Natura 2000.

12.1 Perfundimi i hartimit te Planeve te Menaxhimit per 6 Zona te Mbrojtura ne kuader te projektit SELEA;

12.2 Zbatimi i Planeve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura që tashmë kanë plane të tilla të miratuara, në përputhje me planifikimin e shpenzimeve në PBA si dhe financime të mundshme të projekteve të donatoreve.

12.3 Identifikimi i zonave të mundshme që plotësojnë kriteret për t'u shpallur Natura 2000 sites për Shqipërinë.

12.4 Identifikimi i Rrjetit Ekologjik Kombëtar si pjesë integrale e Rrjetit Ekologjik Pan-Europian;

12.5 Rishikimi dhe përditesimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin (SPVB) për Shqipërinë në linjë me Planin Strategjik Global të Konventës së Biodiversitetit dhe përgatitja e Raportit të Peste Kombëtar për Konventën e Biodiversitetit;

12.6 Rishikimi dhe përditesimi i statusit të llojeve të mbrojtura dhe përditesimi i Listës së Kuqe të Flores dhe Faunes së Eger të Shqipërisë;

13. Objektivat dhe produktet më të mira në **fushën e mbetjeve** në mënyrë të detajuar janë të parashikuara në Strategjinë dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

- Me financim të kFw do hartohen dy studime fizibiliteti për ndërtimin e landfilleve: Tirane-Durrës dhe Vlorë. Fillimi i ndërtimit të landfillit për qarkun e Korçës. Fillimi i mbylljes së venddepozitimit ekzistues të Shkodrës. Transpozimi I direktivave të Komunitetit Europian. Asgjësimi në mënyrë të kontrolluar në landfill në masën 35 %
- Riciklimi I mbetjeve urbane në masën 10 %. Transpozimi I direktivave të Komunitetit Europian. Hartimi i studimit të fizibilitetit për përcaktimin e një venddepozitimi për mbetjet e rrezikshme. Hartimi i planeve rajonale të menaxhimit të mbetjeve.
- Fillimi i mbylljes së venddepozitimit ekzistues të Shkodrës. Transpozimi I direktivave të Komunitetit Europian. Asgjësimi në mënyrë të kontrolluar I mbetjeve që shkojnë në landfill në masën 37 %, riciklimi I mbetjeve urbane në masën 20 %. Hartimi i planeve rajonale të menaxhimit të mbetjeve.
- Fillimi i mbylljes së venddepozitimit ekzistues të Durrësit dhe Sarandës. Fillimi i ndërtimit të landfillit të Sarandës. Transpozimi I direktivave të Komunitetit Europian. Asgjësimi i mbetjeve që shkojnë në landfill në masën 40%. Riciklimi I mbetjeve të ngurta urbane në masën 25 %. Ndërtimi i landfillit për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.

Per Pyjet kullotat

Objektivat afatmesme **2013 - 2015** përfshijnë:

1. Përmirësimi ligjor e institucional për tu përgjigjur ndryshimeve në strukturën e pronësisë mbi pyjet dhe atyre të lidhura me qeverisjen e pyjeve, duke arritur në masën 80% të përputhshmërisë së akteve ligjore me legjislacionin EU në fushën e pyjeve dhe kullotave.
 - a. Transpozimi i kuadrit ligjor Shqiptar me ato evropiane të lidhura me mekanizmat e hedhjes në treg të lëndës drusore nga pyje të certifikuar si dhe të reduktimit të prerjeve ilegale dhe tregtisë së lidhur me të.
 - b. Miratimi i ligjit të Pyjeve dhe Kullotave si dhe e akteve të tjera nënligjore e rregullatorë,
 - c. Zbatimi i reformës institucionale, bazuar në ndarjen e funksioneve dhe atë rajonale;
 - d. Krijimi i qendrës së zhvillimeve teknologjike e inovacioneve në pyje;

- e. Krijimi i forumit të pyjeve (gjithëpërfshirës) për diskutimin e sigurimin e mbështetjes për politikat pyjore e vendimeve madhore të lidhura me zhvillimin e pylltarisë në vend;
2. Sigurimi i te drejtave tradicionale të përdorimit/pronësisë mbi pyjet, duke vendosur mekanizma për reduktimin e prerjeve ilegale dhe tregtimit të lëndës drusore, në masën 50 % si dhe parandalimi i zjarreve në masën 37 % të sipërfaqes së rrezikuar.
 - a. Përcaktimi i një metodologjie për decentralizimin e kontrollit mbi pyjet dhe vendosjen e raporteve të drejta ndërmjet pyjeve të komunitetit, private e shtetërore;
 - b. Përcaktimi i instrumenteve ekonomike e financiare për të vënë në eficientë sektorin e pyjeve;
 - c. Përcaktimi i njësive të këmbimit të shërbimit në ekosistem në kushtet e ekonomisë së tregut dhe ekonomisë së gjelbër.
 3. Rritja e efektivitetit ekonomik dhe e eficiencës energjetike nga përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve shtetërore, rritjen e sipërfaqes pyjore nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit me arvore të pyjore për një sipërfaqe prej 6000 ha, ngritja e një fidanishte pyjore për sigurimin e 4000000 fidanëve arvore të pyjor për mbjellje. Kryerja e punimeve silvikulturore për përmirësimin e grumbujve pyjor me ndërhyrje ripërtëritëse për 3000 ha pyje. Përmirësim kullotash duke realizuar deri 41% të sipërfaqes së planifikuar. Forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të fondit pyjor dhe kullësor.
 - a. Pyllëzimi në zona pilote me kultura intensive (short-rotation) për prodhim biomase dhe uljen e efekteve negative të ngjarjeve ekstreme natyrore (përmbytjeve).
 - b. Nxitja e projekteve konkurruese dhe ekonomikisht eficiente në rehabilitimin e pyjeve dhe vlerësimin e materialit të vdekur të mbetur në pyll.
 - c. Forcimi i partneritetit publik, privat dhe mbështetja e kompanive të specializuara e licencuara për tregtimin e materialit drusor,
 - d. Krijimi i fondit të pyllëzimeve për esenca pyjore-arvore dhe hartimi i rregullores së funksionimit.
 4. Vendosja e sistemit të shërbimeve në ekosistem dhe adaptimi kundrejt ndryshimeve klimatike.
 - a) Pylltaria dhe sekuestrimi i karbonit
 - b) Pylltaria dhe mbrojtja e biodiversitetit pyjor,
 - c) Pylltaria në funksion të shtimit të sasisë dhe cilësisë së ujit.
 5. Përmirësimi i planifikimit të sektorit të pyjeve dhe sistemit të informacionit të data bazës pyjore, hartuar dhe miratuar plane mbarëshpirtimi, azhurnimi i të dhënave të tyre duke realizuar 37% të objektivit si dhe krijimi i njësive territoriale me funksion prodhues dhe menaxhimi i integruar i tyre nëpërmjet teknikave të avancuara.
 - a. Krijimi i njësive territoriale me funksion prodhues dhe menaxhimi i integruar i tyre nëpërmjet teknikave të avancuara;
 - b. Harmonizimi i data bazës së pyjeve me ANFI dhe sistemin e FAO (EEA) në klasifikimin e vegetacionit pyjor;
 - c. Përmirësimi i metodologjisë, informacionit e teknologjisë së regjistrit (kadastrës) Pyjor dhe lidhje e tij automatike me sistemin GIS;
 - d. Korrektimi i mbivendosjes së kufijve, krijuar nga procesi i transferimit të pyjeve komunale;
 - e. Mbivendosja në hartë e planeve të menaxhimit të pyjeve komunale si harta e ngastrave, vegetacionit aktual, pronësisë dhe punimeve;

- f. Përditësimi i të dhënave, bazuar në informacionet e ardhura dhe verifikimet e nivelit të besueshmërisë.
6. Forcimi i sistemit të kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit në pyje.
 - a. Hartimi i një programi kombëtar për rivitalizimin e pyjeve dhe pylltarisë, duke siguruar dhe mbështetur rolin shumë funksional të pyllit, rivitalizuar pylltarinë dhe industrinë e drurit e afte të shfrytëzojë burimet rajonale, kontribuar në shoqëri me karbon të ulët, duke rritur përdorimin e drurit për material dhe energji.
 - b. Hartimi i një strategjie dhe plani veprimi mbi Kërkimin, zhvillimin teknologjik dhe inovacionin në pyje;
 - c. Ndërmarrja e një studimi mbi përlllogaritjen e rritjes vjetore sipas klasave të vegjetacionit;
 - d. Ndërmarrja e një studimi mbi vlerësimin ekonomik të shumë-funksionalitetit në pyje;
 - e. Ndërmarrja e studimeve për rehabilitimin e zonave të mëdha të djegura e të dëmtuara.
 7. Përmirësimi i marrëdhënieve rajonale e me gjere, për shkëmbimin eksperiencave, aplikime të përbashkëta në programe ndërkombëtare dhe unifikimin e teknologjive e metodologjive në masën 50%.
 - a. Forcimi i marrëdhënieve me shërbimet pyjore të vendeve të EU
 - b. Forcimi i marrëdhënieve me shërbimet pyjore të vendeve të rajonit
 8. Aplikimi në programe kombëtare e ndërkombëtare për të siguruar një mbështetje të nevojshme për zhvillimin e pylltarisë në vend.
 - a. Hartimi i një projekti të ri në kuadër të mbështetjes së BB.
 - b. Hartimi i një projekti me SNV për përcaktimin e një skeme financiare, për zhvillimin e pylltarisë komunale bazuar në mekanizmat e ndryshimeve klimatike etj.
 - c. Hartimi i një projekti për reformën institucionale dhe sistemin e edukimit në pyje (Suedi)
 - d. Përpilimi i një projekti për krijimin e dy fidanishteve pyjore Cërrik dhe Devoll

Ne fushen e ujerave

1. Arritja në 60 % e përputhshmërisë së legjislativës kombëtare me ato të BE-së,
 - 1.1 Përafrimi i Direktives Kuader të Ujit 2000/60/EEC, nëpërmjet hartimit të akteve nenligjore – Vendimit të Këshillit të Ministrave, Vendime të Këshillit Kombëtar të Ujit, Rregullore, Urdhëra etj.
 - 1.2 Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore.
 - 1.3 Brenda vitit 2013 është parashikuar të nënshkruhet marrëveshja për menaxhimin e ujerave ndërkufitare me Republikën e Maqedonisë. në bazë të Ligjit Nr. 9103, Datë 10.7.2003, “Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare” dhe në zbatim të VKM Nr. 124, Datë 2.03.2006 "Për krijimin e Komisionit Qeveritar për problemet ujore me vendet fqinjë".
 - 1.4 Brenda vitit 2014 është parashikuar të nënshkruhet marrëveshja për menaxhimin e ujerave ndërkufitare me Republikën e Kosovës. në bazë të Ligjit Nr. 9103, Datë 10.7.2003, “Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare” dhe në zbatim të VKM Nr. 124, Datë 2.03.2006 "Për krijimin e Komisionit Qeveritar për problemet ujore me vendet fqinjë".

2. Shfrytezimi inerteve lumore vetem per qellime te ndertimit te rrugeve kombetare,
 - 2.1 Perditesimi i regjistrit te lejeve te shfrytezimit te inerteve lumore;
 - 2.2 Ndjekja dhe monitorimi i grafikut te reduktimit te lejeve per shfrytezimin e inerteve lumore;
 - 2.3 Ndjekja dhe monitorimi i likuidimit te detyrimeve financiare te subjekteve qe shfrytezojne inerte lumore.
3. Rehabilitimi i shtreterve te lumenjve me 60 % ne krahasim me vitin 2011,
 - 3.1 Kontrolle te vazhdueshme ndaj shfrytezuesve te inerteve lumore, per te siguruar miradministrimin dhe rehabilitim e shtreterve te lumenjve.
4. Menaxhimi i ujerave siperfaqesore dhe nentokesore me qellim reduktimin 95 % krahasuar me vitin 2011 te ndotjes se tyre,
 - 4.1 Monitorimi i cilesise se ujerave siperfaqesore dhe nentokesore nga institucionet pergjegjese ne bashkepunim me MMPAU;
 - 4.2 Ritja e investimeve per monitorimin e cilesise se ujerave siperfaqesore, (ujerave detare, rritje e numrit te stacioneve dhe treguesve);
 - 4.3 Forcimi i disiplines se ligjit ne mbrojtjen e mjedisit per aktivitetet qe shkaktojne ndotje te ujerave, si dhe ndaj atyre qe shfrytezojne basenet ujore;
 - 4.4 Forcimi i kapaciteteve inspektuese nepermjet trajnimeve qe do te zhvillohen;
5. Brenda vitit 2015 te realizohet 50 % zbatimimi i planeve te menaxhimit te baseneve ujore,
 - 5.1 Hartimi i Planeve te Menaxhimit te Baseneve Ujembledhes Vjose dhe Shkumbin, ne zbatim te kerkesave te Direktives Kuader te Ujit 2000/60/EC, dhe Direktives se Permbytjeve 2007/60/EC.
 - 5.2 Hartimi i Termave te References per Hartimin e Planeve te Menaxhimit te Baseneve Drin-Bune dhe Seman.
6. Brenda vitit 2014 te perfundoje inventarizimi 100 % i burimeve ujore krahasuar me vitin 2011.
 - 6.1 Hartimi i Termave te references se Kadastres elektronike (GIS), si nje sistem te dhenash te parametrave sasior dhe cilësor te burimeve ujore.
7. Rritja e nivelit te ardhurave nga perdorimi i burimeve ujore ne buxhetin e shtetit me 60 % ,

Arritja ne masen 80% te perputhshmerise se kuadrit normativ me rregulloret e BE ne fushen e peshkimit dhe akuakultures dhe ujerave te brendshme. 2. Monitorimi dhe analizimi i gjendjes se burimeve peshkore duke bere te mundur analizimin e gjendjes se burimeve peshkore dhe duke evidentuar speciet ne rrezik si dhe llojet e peshkimit qe duhet te ndalohen. 3. Hartimi i politikave per organizimin e mbledhjes se te dhenave ne shkalle

kombetare, te cilat do te perafrohen ne masen 70% me direktivat e BE. Hartimi i politikave per organizimin e tregjeve te produkteve peshkore me shumice dhe pakice duke sjelle kontrollin e prodhimit te zene ne masen 80%, do te nxise permiresimin e cilesise se produktit. Mbrojtja e gjendjes se burimeve peshkore nepermjet programeve te ripopullimit me rasate te prodhuar nga te trete. Monitorimi dhe kontrolli i aktivitetit te peshkimit per anijet e licensuara dhe palicensuar ne lidhje me zbatimin e ligjit dhe ne lidhje me ndotjet mjedisore te ujerave ne masen 100% kjo po behet e mundur me ane te sistemit te kontrollit satelitor.

- a) Ndertimi i 4 merkatove me shumice ne portet e peshkimit me qellim rritjen e cilesise se prodhimit, vleres se prodhimit dhe luftes ndaj tregut informal, per rritjen e shkalles se konkurrences, kjo ne kuader te hartimit te politikave per organizimin e tregjeve te produkteve peshkore me shumice ne qytetet qe kane Port Peshkimi apo me pakice ne qytetet e tjera qe kane aktivitet peshkimi si **Shkoder, Fier, Korçe, Pogradec, Kukes etj.**
- b) Ndertimi i nje shkalle per riparimin e anijeve te peshkimit ne **Portin e Peshkimit Vlore**, ne teritorin ku mund te jepet me koncesion subjektit investues.
- c) Monitorimin e pergjegjshem te zonave te mbrojtura te peshkimit si gjiret detare, gryka lumenjesh, bregdetin ne pergjithesi ne thellesite 50 m izobaten ose mbi 3 milje detare. Kjo, ne menyre te veçante nga peshkimi me trate fundore, per ruajtjen e resurseve peshkore. Kjo do te arrihet nepermjet forcimit te kontrollit per zbatimin e legjislacionit ne fushen e peshkimit.
- d) Selektimin e zonave per akuakulture, duke percaktuar kapacitetet prodhuese per cdo zone
- e) Hartimin e politikave per organizimin e tregjeve te produkteve peshkore me shumice dhe pakice ne zonat me perqendrim te medha te qendrave te akuakultures,
- f) Mbrojtjen e resurseve peshkore nepermjet programeve te ripopullimit te kategorive te medha ujore me rasate te prodhuar nga te tretet.
- g) Forcimi i kontrollit per zbatimin e legjislacionit ne fushen e akuakultures, per perputhshmerine e aktiviteti me kushtet e kontraktuara, ne kategorite e medha ujore dhe vecanerisht ne liqenet nderkufitare.
- h) Rehabilitimin e resurseve peshkore ne zonat lagunore, nepermjet rishikimit te presionit (legal dhe jo legal) mbi gjuetine peshkut, duke hartuar plane menaxhuese specifike per secilen lagune.

Objektivat afatgjata (2015-2020)

Mbrojtja e mjedisit:

- 1). Arritja ne 100% e perputhshmerise se kuadrit normativ me rregulloret e BE ne fushen e Ajrit ne vitin 2020.
- 2). Rritja me 43 % ne vitin 2020 krahasuar me nivelin 28% te vitit 2011, i numrit te stacioneve te monitorimit te ajrit urban sipas standarteve te BE-se ndaj totalit te stacioneve te monitorimit.
- 3). Të reduktohen nivelet kombetare te NOx 15%, te PM10 me 25%, te PM2,5 me 25% krahasuar me nivelet e vitit 2011 perkatesisht: per NOx - 40 μ/m^3 , per PM10 - 83 μ/m^3 , te PM2,5-33 μ/m^3 dhe te ruhen nivelet e e vitit 2011 per SO2 me 8 μ/m^3 .

Disa nga produktet kryesore per arritjen e objektivave te cilesise se ajrit vecanerisht per qytetin e Tiranës jane:

- a) Plan i menaxhimit të cilësië së ajrit në bashkinë e Tiranës i miratuar
- b) Forcimi i kontrollit vjetor te automjeteve
- c) Kuadri institucional për stimulimin e transportit publik i zhvilluar
- d) Sistemi i menaxhimit inteligjent të transportit funksional
- e) Sistemi i kontrollit të Trafikut funksional
- f) Linja të transportit publik në qytet për të mbuluar me linja urbane të gjitha zonat e qytetit
- g) Korsi të dedikuara për autobuzë dhe bicikleta
- h) Vende të reja parkimi nëntokësoretë ndërtuara dhe Zonat pedonale të ndërtuara dhe funksionale
- i) Unaza e madhe e Tiranës e ndërtuar dhe funksionale
- j) Rrjeti i brendshëm rrugor i kompletuar
- k) Rritje te sipërfaqeve të gjelbëruara
- l) Raporte për kontrollet tek shitësit me shumicë dhe pakicë të lëndëve djegëse
- m) Laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare
- n) Inspektorë të kontrollit të cilësisë së karburanteve dhe specialistë të laboratorit të trainuar
- o) Baza e të dhënave në lidhje me cilësinë e benzinës dhe diezelit e krijuar

4). Te reduktohet ndotja akustike me 20% ne zonat kryesore urbane, krahasuar me vitin 2012 (vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së ditës te reduktohen nga 70 dB (A) ne 56 dB dhe vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së natës te reduktohen nga 55 dB (A) ne 45 dB(A).

- a) Ngritja dhe funksionimi i sistemit te monitorimit te zhurmave ne mjedis
- b) Rritja e numrit të stacioneve të monitorimit të zhurmave nga 45 stacione egzistues në vitin 2012, në 60 stacione deri në vitin 2020.
- c) Studimi dhe Vleresimi i gjendjes se sinjalistikes rrugore dhe hekurudhore per zhurmat dhe propozimi i masave konkrete per nderhyrje
- d) Vleresimi dhe hartimi i nje inventari kombetar (data- base) mbi numrin e pajisjeve dhe makinerive qe shkaktojne zhurma ne mjedis dhe abdetimi i tij i perhershëm
- e) Forcimi i zbatimit te legjislacionit per zhurmat

5). Arritja ne 100% e perputhshmerise se kuadrit normativ me rregulloret e BE ne fushen e zhurmave ne vitin 2020.

7) Brenda viti 2020, 100% e operatoreve te medhenj industriale te jene ne perputhje te plote me normat e shkarkimeve ne ajer (PM10, SO2, NOx) dhe uje sipas kerkesave te ligjit "Per lejet mjedisore" dhe standarteve te percaktuara ne direktivave IPPC dhe LCP, krahasuar me vitin 2013.

8). Arritja ne 100% e perputhshmerise se kuadrit normativ me Rregulloren REACH dhe CLP te BE ne fushen e kimikateve ne vitin 2020.

8.1 Hartimi i udhëzuesve lidhur me incidentet industriale nga kimikatet e rrezikshme, menaxhimin e incidenteve, toksikologjine ne pergjithesi, masat e sigurisë dhe mbrojtjes nga kimikatet e rrezikshme, metodat e dekontaminimit, perdorimit te antidoteve apo pajisjeve ndihmese gjate ndodhjes se nje emergjence kimike.

- 8.2 Hartimi i procedurave për menaxhimin e kimikateve dhe materialeve të rrezikshëm si dhe metodat për eliminimin e mbetjeve të tyre nga laboratorët.
- 8.3 Krijimi i bazave të të dhënave p.sh. për kimikatet e përdorur në industri (sasitë dhe llojet e mbetjeve industriale të reja që gjenerohen nga aktiviteti i subjekteve industriale të licencuara pas vitit 1992), për kimikatet e rrezikshme, si biocidet, PMB, për planet e emergjencave, etj.;
- 8.4 Rritja e numrit të stafit që angazhohet me menaxhimin e kimikateve jo vetëm në numër, por një staf cilësor, i aftë për të përballuar kërkesat e shumta të kësaj fushe që kërkon nivel shumë të lartë ekspertize.
- 8.5 Organizimi i trajnimeve nga Qendra Kombëtare e Trajnimit, në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal për autoritetet kompetente dhe operatorët industriale për parandalimin, gadishmerinë dhe përgjigjen ndaj emergjencave kimike.
- 8.6 Organizimi i trainimeve dhe rritje e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për informimin mbi kimikatet.
- 8.7 Aktivitete për rritjen e ndergjegjesimit të popullsisë mbi rrezikun kimikateve dhe e aksidenteve industriale të shkaktuara prej tyre.
- 8.8 Hartimi i programeve trajnuese për inspektorët dhe stafet profesionale, metodologjikisht të konsoliduar si në trajtën e programeve të plotë për formimin e stafit të ri, ashtu edhe programe të shkurtër rifreskues.
- 8.9 Aktivitete ndërgjegjësimi në të gjitha grupmoshat si dhe trajnimi i grupeve të ndryshme të profesionistëve, si fermerëve, transportuesve, industrialistëve, stafit teknik, si edhe i konsumatorit, për sigurinë në përdorimin e kimikateve.
- 9). Ulja e nivelit të cilimit të gazeve me efekt sërre me 16% në vitin 2020, krahasuar me skenarin bazë (18000Gg CO₂ eqv)
- 9.1 ulja e nivelit të substancave ozonholluese Hidroklorflorkarbon (HCFC) në vitin 2020 deri në 78 ton krahasuar me vitin 2011 prej 120 ton/vit, me qëllim që të kontribuohet për parandalimin e ndryshimeve të klimes.
- 9.2 Zbatim i kërkesave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë të ratifikuar nga Parlamenti
- 9.3 Zbatimi i kërkesave të legjislacionit për energjitë e rinovueshme dhe eficiencës së energjisë
- 9.4 Adoptimi i lehtësirave fiskale për investime në përdorimin me eficiencë të burimeve natyrore.
- 9.5 Ngritja e sistemit kombëtar të monitorimit, verifikimit dhe raportimit të gazeve me efekt sërre
- 10). Arritja në 100 % e përputhshmërisë së kuadrit normativ me direktivat e BE në fushën e Ndryshimeve Klimatike në vitin 2020.
- 11) *Zbatimi i direktivave të fushës së mbrojtjes së natyrës dhe peizazhit;*
- 11.1 Përfundimi i studimit për rrjetin Emerald të Zonave me Interes të Veçantë Ruajtjeje (ZIVR) në kuadër të Konventës së Bernes “Për ruajtjen e jetës së eger dhe të habitateve natyrore evropiane”;

11.2 Zbatimi i masave mbrojtëse për llojet dhe habitatet e listuara në Aneksin e Direktives së habitateve dhe të Shpendeve;

11.3 Zbatimi në praktike të rregullues "Për mbajtjen e kafshëve në Kopshtet Zoologjike";

11.4 Zbatimi në praktike të rregullues së BE-së për tregtine ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të faunës dhe floras së eger;

11.5 Zbatimi në praktike të një sistemi gjithëpërfshirës të monitorimit të biodiversitetit;

12) Krijimi i sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura të Zonave të Mbrojtura detare dhe bregdetare në 10 % të sipërfaqes ujore të vendit në linjë me Aichi targets të Konventës së biodiversitetit për 2020;

12.1 Shpallja e dy Zonave të Mbrojtura detare në përputhje me dokumentin strategjik të hartuar dhe miratuar për këto qëllime.

12.2 Hartimi i Planeve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura për zonat e reja të shpallura dhe përditesimi/rishikimi i planeve ekzistuese;

12.3 Studim kombëtar për riklasifikimin e Zonave të Mbrojtura, bazuar në kriteret e reja të publikuara nga Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës (IUCN).

13) Zbatimi i planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe planeve të veprimtimit të llojeve dhe habitateve, identifikimi dhe studimi i zonave Natura 2000 për Shqipërinë.

13.1 Zbatimi i masave konkrete të parashikuara në planin e menaxhimit për të siguruar statusin e favorshëm të ruajtjes për llojet dhe habitatet globalisht të kërcënuara.

13.2 Përgatitja e propozimeve për Natura 2000 sites për Shqipërinë në formatin e kërkuar nga Komisioni Evropian;

13.3 Zbatimi i planeve të menaxhimit të Zonave të Mbrojtura sipas buxhetit të alokuar në PBA dhe projekte të mundshme të donatoreve.

14. Objektivat dhe produktet më të mira në **fushën e mbetjeve** për periudhën 2013-2020 janë të parashikuara në mënyrë të detajuar në Strategjinë dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

- Zhvillimi i landfilleve rajonale. Mbyllja dhe monitorimi i venddepozitimeve ekzistuese bashkiake. Transpozimi i direktivave të Komunitetit Evropian. Asgjësimi i mbetjeve që shkojnë në landfill në masën 42%; riciklimi i mbetjeve urbane në masën 30 %.
- Zhvillimi i landfilleve rajonale. Mbyllja dhe monitorimi i venddepozitimeve ekzistuese bashkiake. Transpozimi i direktivave të Komunitetit Evropian. Asgjësimi i mbetjeve që shkojnë në landfill në masën 45%; riciklimi i mbetjeve urbane në masën 35 %.
- Zhvillimi i landfilleve rajonale. Mbyllja dhe monitorimi i venddepozitimeve ekzistuese bashkiake. Transpozimi i direktivave të Komunitetit Evropian. Zbatimi i sistemit të grumbullimit me tre kosha. Zbatimi i projekteve të ndarjes së mbetjeve të kompostueshme dhe të thata (leter, qelq, plastike, metal). Përmirësimi i sistemit të grumbullimit të mbetjeve në të gjitha zonat e mbetjeve. Asgjësimi i mbetjeve që shkojnë në landfill në masën 55%; riciklimi i mbetjeve urbane në masën 45 %.
- Zhvillimi i landfilleve rajonale. Mbyllja dhe monitorimi i venddepozitimeve ekzistuese bashkiake. Transpozimi i direktivave të Komunitetit Evropian. Asgjësimi i mbetjeve që shkojnë në landfill në masën 50%; riciklimi i mbetjeve urbane në masën 50 %.

- Zhvillimi i landfilleve rajonale. Mbyllja dhe monitorimi i venddepozitimeve egzistuese bashkiake. Transpozimi I direktivave te Komunitetit European. Asgjesimi I mbetjeve qe shkojne ne landfill ne masen 45%; riciklimi I mbetjeve urbane ne masen 55 %.

Pyjet dhe kullotat

Objektivat afatgjata 2015-2020 përfshijnë:

1. Brenda vitit 2020 ne legjislacionin kombëtar te arrihet transpozimi i plote i plote (100 %) i legjislacionit european, ne fushën e pyjeve krahasuar. Sigurimi i kuadrit rregullator, institucional dhe ekonomik për zbatimin e menaxhimit te qëndrueshëm te pyjeve.
2. Sigurimi i te drejtave tradicionale te përdorimit/pronësisë mbi pyjet, duke vendosur mekanizma për reduktimin e prerjeve ilegale dhe tregtimit te lendes drusore, në masën 100 % si dhe parandalimi i zjarreve ne masën 80 % te sipërfaqes se rrezikuar.
3. Rritja e efektivitetit ekonomik dhe e eficiencës energjetike nga përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve shtetërore, rritjen e sipërfaqes pyjore nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit me arvore e pyjore ne masën 15% të sipërfaqes me bimësi pyjore dhe djerr, ngritja e një fidanishte pyjore për sigurimin e 4000000 fidanëve arvore e pyjor për mbjellje. Kryerja e punimeve silvikulturore për përmirësimin e grumbujve pyjor me ndërhyrje ripërtëritëse për 30000 ha pyje. Përmirësim kullotash duke realizuar deri 80% te sipërfaqes se planifikuar. Forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të fondit pyjor dhe kullor ne masën 100. Parandalimit te gërryerjes se mëtejshme te tokës pyjore dhe kullor ne 25 % te sipërfaqes,deri ne 2020.
4. Vendosja deri ne vitin 2020 te sistemit te shërbimeve ne ekosistem dhe adaptimi kundrejt ndryshimeve klimatike ne masën 100.
5. Realizimi i data bazën pyjore (GIS), hartimi dhe miratimi i planeve mbarështimit për 100% të fondit pyjor dhe kullor, azhurnimi i të dhënave të tyre duke realizuar 100% të objektivit si dhe përmbushja e krijimit te njësite territoriale me funksion prodhues dhe menaxhimi i integruar i tyre nëpërmjet teknikave te avancuara.
6. Forcimi i sistemit të kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit në pyje.
7. Vendosja e marrëdhënieve rajonale e me gjere, për shkëmbimin eksperiencave, aplikime te përbashkëta ne programe ndërkombëtare dhe unifikimin e teknologjive e metodologjive ne masën 80%.
8. Sigurimi i mekanizmave financiare për të përmirësuar statusin e pyjeve dhe zhvillimin e sektorit te pyjeve.
 1. Ne fushen e ujerave te perputhet me 100 % kuadri ligjor kombetar me legjislacionin e BE-se brenda vitit 2020.
 2. Brenda vitit 2020 te arrihet rritja me 100 % e te ardhurave nga perdoruesit e ujerave

3. Brenda vitit 2020 te arrihet plotesisht mbrojtja e ekosistemeve lumore,
4. Brenda vitit 2020 te arrihet 90% e rehabilitimit te shtreterve te lumenjve
5. Brenda vitit 2020 te realizohet monitorimi i burimeve ujore termale
6. Te zbatohen mareveshjet dypaleshe te arritura per burimet ujore te perbashketa brenda vitit 2020.
7. Te realizohet mbrojtja dhe permiresimi i cilesise se ujerave nepermjet zbatimit te Planeve te Menaxhimit te Burimeve Ujore brenda vitit 2020
 - a) Perafrimi i plote i Direktives Kuader te Ujit 2000/60/EEC, nepermjet hartimit te akteve nenligjore – Vendimit te Keshillit te Ministrave, Vendime te Keshillit Kombetar te Ujit, Rregullore, Urdhera etj
 - b) Kontrolle te vazhdueshme ndaj perdoruesve te burimeve ujore, per te siguruar miradministrimin dhe perdorimin e qendrueshem te tyre.
 - c) Perditesimi i regjistrit te lejeve te burimeve ujore termale;
 - d) Ndjekja dhe monitorimi i subjekteve te cilat shfrytezojne inertet lumore me leje te perkohshme.
 - e) Ndjekja dhe monitorimi i likuidimit te detyrimeve financiare te subjekteve qe burimet ujore.
 - f) Takime te grupeve te perbashketa te punes dhe Komisioneve Nderqeveritare me vendet fqinje per shfrytezimin e burimeve ujore te perbashketa.
 - g) Monitorimi i vazhdueshem i cilesise se ujerave siperfaqesore dhe nentokesore nga institucionet pergjegjese ne bashkepunim me MMPAU-ne. .

Arritja ne masen 100% te perputhshmerise se kuadrit normativ me rregulloret e BE ne fushen e Peshkimit dhe akuakultures dhe ujerat e brendshme. 2. Monitorimi i gjendjes se burimeve peshkore ne masen 80% duke bere te mundur analizimin e gjendjes se burimeve peshkore dhe duke evidentuar tendencen e speciet (per ato qe jane ne rrezik ose ato qe kane tendence rritje) duke percaktuar limite per kohen e zenies, llojet e peshkimi. 3. Hartimi i politikave per organizimin e mbledhjes se te dhenave ne shkalle kombetare, te cilat do te perafrohen ne masen 100% me direktivat e BE. Hartimi i politikave per organizimin e tregjeve te produkteve peshkore me shumice dhe pakice duke sjelle kontrollin e prodhimit te zene ne masen 80%, do te nxise permiresimin e cilesise se produktit. Mbrojtja e gjendjes se burimeve peshkore nepermjet programeve te ripopullimit me rasate te prodhuar nga te trete. Monitorimi dhe Kontrolli i aktivitetit te peshkimit per anijet e licensuara dhe palicensuar ne lidhje me zbatimin e ligjit dhe ne lidhje me ndotjet mjedisore te ujerave ne masen 100% kjo po behet e mundur me ane te sistemit te kontrollit satelitor.

- a) Hartimin e politikave per organizimin e tregjeve te shumices e pakices si dhe certifikimi i gjithes prodhimit te peshkut te zene dhe i produktet peshkore, kjo nepermjet ndertimit te 4 merkatove me shumice ne portet e peshkimit me qellim rritjen e cilesise se prodhimit, vleres se prodhimit dhe luftes ndaj tregut informal, per rritjen e shkalles se konkurences.
- b) Zgjerimi i porteve egzistues, ndertimi i shkalleve per riparimin e anijeve dhe ndertimi i bankinave te ankorimit te anijeve te peshkimit ne **Vlore, Sarande dhe Shengjin**.
- c) Ngritja e infrastrukturave (*shkalleve*) te riparimit, mirembajtjes te anijeve te peshkimit ne te kater portet e vendit, me qellim rritjen e tregueseve te gadishmerise teknike dhe te shfrytezimit maksimal ne peshkim te flotes se peshkimit detar.

- d) Financimi per kompensimin e TVSH-se se çmimit të karburantit që përdorin anijet e peshkimit.
- e) Mbeshtetja për dhënie të kredive të buta për subjektet e peshkimit detar, për riparimin e modernizimin e anijeve të peshkimit.
- f) Hartimin e politikave për organizimin e tregjeve dhe certifikimit/stimulimit të implementimit të skemave kualitative për produktet peshkore të akuakultures,
- g) Mbrojtjen e resurseve peshkore në kategoritë e mëdha ujore të ujërave të brendshme nëpërmjet programeve të ripopullimit me rrasa të prodhuar nga të tjerët.
- h) Menaxhimin e lagunave me kritere të mirëpërcaktuara dhe ligjore, duke mbrojtur ekosistemet specifike që ka çdo lagunë.

Kapitulli 4: **Burimet financiare**

Në përparim të Dokumentit Strategjik Ndersektorial për mjedisin për periudhën 2013-2020, si dhe Dokumentin Strategjik Ndersektorial për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve janë mbajtur parasysh problematikat e ndeshura gjatë aktivitetit të viteve të kaluara dhe janë reflektuar me drejtë lidhjet ndërmjet objektivave, produkteve dhe aktivitetëve që duhet të realizohen për gjithë Ministrinë e Mjedisit. Janë zbatuar tavanet e paraqitura nga Ministria e Financës për të gjitha fondet e shpenzimeve buxhetore. Në hartimin e këtyre dokumenteve janë patur parasysh një sërë kërkesash që lidhen me realizimin e objektivave prioritare të qeverisë në fushën e mjedisit, pyetjeve, ujërave dhe peshkimit si më poshtë:

1. Forcimi i kontrollit për zbatimin e legjislativës në fushën e mjedisit, pyetjeve, peshkimit dhe ujërave.
2. Rehabilitimi i zonave të ndotura.
3. Përmirësimi i cilësisë së ajrit në zonat urbane.
4. Mbrojtja nga erozioni nëpërmjet mbjelljeve të fidaneve pyjore dhe të ndërtimit të pritave malore.
5. Ndalimi i prerjeve të paligjshme në pyje dhe rritja e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura.
6. Ngritja e sistemi kombëtar të menaxhimit të integruar të mbetjeve
7. Ngritja e sistemit të menaxhimit të kimikateve
8. Adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike
9. Parandalimi i zjarreve si dhe masat e nevojshme për shuarjen e tyre.

Fondet që janë parashikuar në arritjen e këtyre objektivave përfshijnë pagat dhe pagesat e sigurimeve shoqërore për të gjithë stafin e MMPAU dhe strukturat vartëse të miratuara me vendimet përkatëse, pagesat për mallra dhe shërbimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetëve, transferime korrente me entitetet brenda dhe jashtë vendit dhe shpenzimet kapitale që kanë të bëjnë me projekte specifike me investime të brendshme dhe të huaja.

Disa nga projektet që do të implementohen për realizimin e objektivave me financim të huaj përfshijnë:

- Projekti: “Transformimi i tregut për përdorimin e paneleve diellore për ujë të ngrohtë në Shqipëri”;
- Projekti: “Identifikimi dhe zbatimi i masave për adaptim në deltën e lumenjve Drini–Mati”;
- Komunikimi i Tretë Kombëtar;

- Projekti GEF-UNDP “Menaxhimi i Zonave të Mbrojtura Detare dhe Bregdetare”;
- Projekti ”Zbatimi i kuadrit kombëtar për Biosigurinë në Shqipëri”;
- Projekti ”Rishikimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimave të Biodiversitetit”;
- Projekti i ozonit;
- Projekti ”Forcimi i kapaciteteve të MMPAU për hartim dhe zbatim legjislativ”
Ndertimi i portit të ri të Peshkimit në Durrës;
- Projekti “Menaxhimi i Integruar i Ekosistemit të basenit të Prespes”;
- Projekti IPA 2010 - CEMSA Konsolidimi i sistemit të monitimit në Shqipëri”;
- Projekti “Përmirësimi i menaxhimit të burimeve natyrore ”
- Projekti i Cooperazione Italiana “Hartimi i planeve të menaxhimit të PK Shebenik-Jabllanice dhe Peizazhit të Mbrojtur Velipoje”.
- Projekti i JICA-s japoneze “Ruajtja e biodiversitetit në Parkun Kombëtar Divjake-Karavasta dhe hartimi i planit të menaxhimit të Parkut”;
- Projekti KfW-GIZ “Ruajtja e biodiversitetit në Liqenet e Shkodrës, Ohrit dhe Prespes”
- Projekti IPA 2013 (në proces negocijimi për fundimtar me Delegacionin Evropian);
- Projekti IPA CBC 2013 “Drejt forcimit të qeverisjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore të përbashkët ndërkufitare të Liqenit të Ohrit” (në proces negocijimi për fundimtar me Delegacionin Evropian);
- Projekti GEF për Zbatimin e Planit Strategjik shkretëtirezimit të tokës.

Projekti “Për rezervat ujore dhe ujëjitjen” në bashkëpunim MMPAU dhe MBUMK me asistencën e Bankës Botërore.

- Ndertimi i sistemit të ri të furnizimit me ujë Bilisht;
- Përgatitja e një projekti të ri në fushën e ujëjitjes;
- Projekti i kanalizimeve të Tiranës së Madhe;
- Asistencë Teknike (IPA 2010, ADA);
- Ndertimi i impiantit të ujerave të përdorura në qytetin e Kavajës, faza II, IPA 2009;
- Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit KUZ në Lezhë/Shëngjin, IPA 2009;
- Ndertimi i rrjetit sekondar dhe terciar në qytetin e Vlores, IPA 2009;
- Projekti i Kanalizimeve për Ksamilin, IPA 2009;
- Përfundimi i sistemit KUZ në zonën e Velipojës, IPA 2010;
- Mbrojtja mjedisore e liqenit të Ohrit, kanalizimet e ujerave të zeza, Pogradec (faza III);
- Programi i infrastrukurës komunale I për qytetet Fier, Gjirokastër, Sarandë dhe Lezhë;
- Programi i infrastrukurës komunale II për qytetet Kamez, Elbasan, Lishnje, Berat/Kucovë, Fier dhe Sarandë;
- Projekti i ri në fushën e ujëjitjes.
Për më tepër detajim mund të referoheni tabelave bashkëlidhur në lidhje me shpenzimet e parashikuara në programet buxhetore që është e organizuar Ministria e Mjedisit për zbatimin e politikave ndërsektoriale më të larta.

Në fushën e mbetjeve financimi është parashikuar në dy faza:

Në Fazën e 1-re të financimit, do të sigurohet nëpërmjet programit të financimit të Qeverisë Qendrore dhe nëpërmjet financave të premtuara nga bashkësia kolektive edonatorëve ndërkombëtarë, qoftë si donacione, apo si marrëveshjeve të posaçmefinanciare të kredisë. Këto fonde do të menaxhohen përmes mekanizmave të Qeverisë qendrore dhe bashkërendimit të njesive së donatoreve në Këshillin e Ministrave. Nëse këto fonde do të krijojnë një Fond Mjedisor kryesor ose jo është ende për t'u vendosur.

Në Fazën 2-te fondet do të vijnë kryesisht nga programi I fondeve të qeverisë qendrore

dhe nga programet e infrastrukturës së fondeve të BE. Në çdo rast shpenzimet perzbatimin dhe perputhjen me Struktura e Direktivave të BE mbi mbetjet është llogariturperafersisht mes € 150 dhe € 200 milion, me kosto operative te shtuar vjetore prej rreth €52 milion në vit deri në vitin e 13-te pas zbatimit. Ne menyre te detajuar buxheti per menaxhimin e integruar te mebtjeve jepet ne Strategjine dhe Planin Kombetar te menaxhimit te mbetjeve.

Per me teper detajim mund tu referoheni tabelave bashkelidhur ne lidhje me shpenzimet e parashikuara ne programet buxhetore qe eshte e organizuar Ministria e Mjedisit per zbatimin e politikave ndersektoriale madhore.

* ne mije LEK

2012

Nr	Emertimi Programit	TOTALI	600-601	602-606	Inv Brend	Inv Huaj
1	Planifikim Menaxhim Administrim	116,415	64,062	30,353	22,000	
2	Program per Mbrojtjen e Mjedisit	1,051,335	195,495	39,840	112,000	704,000
3	Mbeshtetje per Peshkim	372,768	49,258	27,510	96,000	200,000
4	Administrimi Ujerave	50,139	33,489	16,650		
5	Administrimi Pyjeve	713,691	553,691	110,000	50,000	
	Totali	2,304,348	895,995	224,353	280,000	904,000

2013

Tavanet e rishikuara		920,000	200,000	100,000	520,000
----------------------	--	----------------	----------------	----------------	----------------

Nr	Emertimi Programit	TOTALI	600-601	602-606	Inv Brend	Inv Huaj
1	Planifikim Menaxhim Administrim	113,391	61,333	27,058	25,000	
2	Program per Mbrojtjen e Mjedisit	665,840	200,323	35,518	25,000	405,000
3	Mbeshtetje per Peshkim	245,518	55,991	24,527	50,000	115,000
4	Administrimi Ujerave	49,171	34,327	14,844		
5	Administrimi Pyjeve	666,079	568,026	98,054		
	Totali	1,740,000	920,000	200,000	100,000	520,000

2014

Tavanet e rishikuara		964,000	206,000	60,000	327,000
----------------------	--	----------------	----------------	---------------	----------------

Nr	Emertimi Programit	TOTALI	600-601	602-606	Inv Brend	Inv Huaj
1	Planifikim Menaxhim Administrim	117,135	64,267	27,868	25,000	
2	Program per Mbrojtjen e Mjedisit	538,494	209,918	36,576	35,000	257,000
3	Mbeshtetje per Peshkim	153,921	58,661	25,260		70,000
4	Administrimi Ujerave	51,330	36,037	15,293		
5	Administrimi Pyjeve	696,120	595,117	101,003		
	Totali	1,556,000	964,000	206,000	60,000	327,000

2015

Tavanet e rishikuara		999,000	210,000	100,000	420,000
----------------------	--	----------------	----------------	----------------	----------------

Nr	Emertimi Programit	TOTALI	600-601	602-606	Inv Brend	Inv Huaj
1	Planifikim Menaxhim Administrim	100,004	66,600	28,404	5,000	
2	Program per Mbrojtjen e Mjedisit	629,788	217,500	37,288	45,000	330,000
3	Mbeshtetje per Peshkim	176,556	60,800	25,756		90,000
4	Administrimi Ujerave	52,871	37,300	15,571		
5	Administrimi Pyjeve	769,781	616,800	102,981	50,000	
	Totali	1,729,000	999,000	210,000	100,000	420,000

* ne milion LEK

2016

Nr	Emertimi Programit	TOTALI	600-601	602-606	Inv Brend	Inv Huaj
1	Planifikim Menaxhim Administrim	110	74	31	5	
2	Program per Mbrojtjen e Mjedisit	490	227	40	23	200
3	Mbeshtetje per Peshkim	155	57	28		70
4	Administrimi Ujerave	156	39	17		100
5	Administrimi Pyjeve	885	643	112		130
	Totali	1,796	1,040	228	28	500

Tavanet e rishikuara	1,967	1,079	230	58	600
----------------------	--------------	--------------	------------	-----------	------------

2017

Nr	Emertimi Programit	TOTALI	600-601	602-606	Inv Brend	Inv Huaj
1	Planifikim Menaxhim Administrim	113	77	31	5	
2	Program per Mbrojtjen e Mjedisit	659	235	41	53	330
3	Mbeshtetje per Peshkim	167	59	28		80
4	Administrimi Ujerave	158	41	17		100
5	Administrimi Pyjeve	870	667	113		90
	Totali	1,967	1,079	230	58	600

Tavanet e rishikuara	2,228	1,116	238	74	800
----------------------	--------------	--------------	------------	-----------	------------

2018

Nr	Emertimi Programit	TOTALI	600-601	602-606	Inv Brend	Inv Huaj
1	Planifikim Menaxhim Administrim	117	80	32	5	
2	Program per Mbrojtjen e Mjedisit	755	244	42	69	400
3	Mbeshtetje per Peshkim	190	61	29		100
4	Administrimi Ujerave	210	42	18		150
5	Administrimi Pyjeve	957	690	117		150
	Totali	2,228	1,116	238	74	800

Tavanet e rishikuara	2,326	1,164	242	119	800
----------------------	--------------	--------------	------------	------------	------------

2019

Nr	Emertimi Programit	TOTALI	600-601	602-606	Inv Brend	Inv Huaj
1	Planifikim Menaxhim Administrim	121	83	33	5	
2	Program per Mbrojtjen e Mjedisit	931	254	43	114	520
3	Mbeshtetje per Peshkim	154	64	30		60
4	Administrimi Ujerave	172	44	18		110
5	Administrimi Pyjeve	948	719	119		110
	Totali	2,325	1,164	242	119	800

* ne milion LEK

Tavanet e rishikuara	2,407	1,213	252	142	800
----------------------	--------------	--------------	------------	------------	------------

2020

Nr	Emertimi Programit	TOTALI	600-601	602-606	Inv Brend	Inv Huaj
1	Planifikim Menaxhim Administrim	126	87	34	5	
2	Program per Mbrojtjen e Mjedisit	847	265	45	137	400
3	Mbeshtetje per Peshkim	198	67	31		100
4	Administrimi Ujerave	214	45	19		150
5	Administrimi Pyjeve	1,023	750	124		150
	Totali	2,407	1,213	252	142	800

Kapitulli 5: Llogaridhenia, monitorimi dhe analiza vleresuese

Sistemi ekzistues i monitorimit:

Monitorimi i mjedisit kryhet ne perputhje me VKM Nr. 1189 date 18.11.2009 “ Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit” ku jane percaktuar organet qendrore dhe institucionet monitoruese per zbatimin e programit kombëtar te monitorimit.

Institucionet monitoruese, në bazë të programit, japin me hollësi dhe hartojnë projekte të veçanta për monitorimin e treguesve mjedisorë, të marrë përsipër prej tyre, të cilët i paraqesin në MMPAU si oferta. Projektet e institucioneve monitoruese shërbejnë si bazë për konkurrim dhe për lidhjen e kontratave të monitorimit.

Institucionet monitoruese

- Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve
- Instituti i Shëndetit Publik
- Instituti i Gjeoshkences, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës
- Sherbimi Gjeologjik Shqiptar
- Universiteti Bujqësor
- Universiteti i Tiranes, Shkodres, Vlores.
- Instituti Hidrometeorologjik
- REC Shqiperi
- Agjensite e Basenve Ujembledhese
- Instituti i Peshkimit Durres
- Ministrite e linjes

Institucione bashkepunuese

Per te siguruar te dhenat per hartimin e inventarit kombetar te shkarkimeve ne ajer dhe inventarit kombetar te gazeve me efekt serre, kerkohet te institucionalizohet mbledhja e te dhenave nga institucionet qendrore te meposhteme:

- Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes
- Ministria e Puneve Publike dhe Transporteve
- Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit
- Ministria e Mbrojtjes
- Ministria e Shendetesise
- Ministria e Financave
- Ministria e Kultures, Turizmit, Rinise dhe Sporteve
- Ministria e Brendeshme
- INSTAT
- MITIK

Te dhenat e grumbulluara nga monitorimi dhe analiza e rezultateve do te behet konform kerkesave dhe rekomandimeve te Direktives “INSPIRE” 2007/2/EC dhe ligjit Nr.72/2012

“Per organizimin dhe funksionimin e infrastruktures kombetare te informacionit gjeohapesinor ne RSH”

Lista e treguesve:

Objektivi 1: Të reduktohen nivelet kombetare te NO_x 15%, te PM₁₀ me 25%, te PM_{2,5} me 25% dhe te ruhen nivelet e SO₂ brenda vitit 2020 krahasuar me nivelet e vitit 2011 perkatesisht: per NO_x - 40 μ/ m³, per PM₁₀ - 83 μ/ m³, te PM_{2,5}-33 μ/ m³ dhe SO₂-8 μ/ m³.

Indikatorët:

1. Përqindja e rasteve të përputhjes se treguesve te cilesise se ajrit; PM₁₀, PM_{2,5}, me standartet europiane te cilesise së ajrit, eshte rritur: (i) nga 30% per PM₁₀ dhe PM_{2,5} ne 2011 ne 55 % ne 2020;
2. Përqindja e rasteve të përputhjes se treguesve te cilesise se ajrit; per treguesit e SO₂, NO₂, CO, Pb, O₃ (99%), dhe benzen (95%) te ruhen vlerat e 2011.
3. Sasia vjetore ne Kton per ndotesit acidifikues: SO₂, NO_x dhe NH₃
4. Sasia vjetore ne mij ton CO₂ e shkarkimit te gazeve me efekt serre.

Objektivi 2: Mbrojtja dhe permiresimi i cilesise se ujerave sipas legjislacionit te transpozuar ne fuqi me qellim reduktimin 95 % krahasuar me vitin 2011 te ndotjes se tyre.

Indikatorët:

5. Përqindja e rasteve të përputhjes se treguesve te cilesise se ujerave; NBO₅, NH₄, O₂ i tretur, NO₃, P-total, me standartet europiane te cilesise së ujerave, eshte rritur: (i) nga 53% per NBO₅, ne 2011 ne 55 % ne 2012;
6. Përqindja e rasteve të përputhjes se treguesve te cilesise se ujerave; NBO₅, NH₄, O₂ i tretur, NO₃, P-total, me standartet europiane te cilesise së ujerave, eshte rritur:(ii) nga 43% NH₄ ne 2011 ne 45 % ne 2012;
7. Përqindja e rasteve të përputhjes se treguesve te cilesise se ujerave; NBO₅, NH₄, O₂ i tretur, NO₃, P-total, me standartet europiane te cilesise së ujerave, eshte rritur:(iii) nga 53% per P-total, ne 2011 ne 55 % ne 2012
8. Përqindja e rasteve të përputhjes se treguesve te cilesise se ujerave; NBO₅, NH₄, O₂ i tretur, NO₃, P-total, me standartet europiane te cilesise së ujerave(iv) per treguesit e O₂ i tretur, dhe NO₃ te ruhen vlerat e 2011, te cilat jane brenda standarteve.

Objektivi 3: Asgjësimi i mbetjeve që shkojnë në landfill në masen 45% dhe riciklimi i mbetjeve urbane në masën 55%.

Indikatorët:

Indikator 1. Përqindja e mbetjeve qe shkojne ne landfille sanitare kundrejt mbetjeve te hedhura ne venddepozitime te hapura eshte rritur nga nga 35 % ne 2010 ne 45% ne 2020.

Indikator 2: Rritja e sasise se mbetjeve qe riciklohen nga 10 % ne vitin 2010 ne 55 % ne vitin 2020.

Objektivi 4. Ulja e nivelit të çlirimit të gazeve të efektit serrë dhe substancave ozon-holluese, me qëllim që të kontribuohet për parandalimin e ndryshimit të klimës

Indikatorët:

1. Sasia e substancës ozonholluese HidroKlorflorkarbon (HCFC) do të reduktohen nga 120 ton në vitin 2010 në 78 ton në vitin 2020, duke ruajtur të pandryshuar sasinë prej 120 ton deri në vitin 2013.

Objektivi 5: Menaxhimi i qëndrueshëm i komponentëve mjedisore me qëllim miradministrimin e burimeve natyrore dhe mbrojtja e mjedisit në tërësi.

Indikatorët:

1. Ulja e prerjeve të pa ligjeshme në pyje.
2. Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullësor mbuluar me plane mbarështimi nga 50 % në 2010 në 52 % në vitin 2012.
3. Plane të menaxhimit të baseneve lumore të hartuara dhe monitorimi i zbatimit të tyre.

Objektivi 6: Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, zonave dhe llojeve të mbrojtura, me qëllim që të ruhet trashëgimia natyrore dhe kulturore e mjedisit;

Indikatorët:

1. Rritja e sipërfaqes së zonave të mbrojtura në shkallë vendi
2. Rritja e përqindjes së zonave të mbrojtura (Parqeve Kombëtare) me Plane Menaxhimi të miratuara

Objektivi 7: Monitorimi dhe analizimi i gjendjes së burimeve peshkore duke bërë të mundur aplikimin e politikave menaxhuese dhe masave frenuese në shfrytëzimin e resurseve ujore, duke u bazuar në evidencat më të mira shkencore.

Indikatorët:

1. Vlerësimi i dendesise së rezervës peshkore dhe raportimi i tyre njëvjeçarë nga Instituti i Kerkimit Peshkimit.
2. Raporte statistikore deri në një vjeçarë të të dhënave të produkteve si dhe të dhënave të tjera social ekonomike.